



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.180**

**dhjetor**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Urdhër i MPPT  
nr.123, datë 22.12.2011

Për miratimin e rregullores për integrimin në një bazë qendrore të informacionit për ngjarjet në aviacionin civil dhe shpërndarjen e këtij informacioni te palët e interesuara..... 10121

Rregullore e AMF

Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit..... 10126

**URDHËR**  
**Nr.123, datë 22.12.2011**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR INTEGRIMIN NË NJË BAZË QENDRORE TË  
INFORMACIONIT PËR NGJARJET NË AVIACIONIN CIVIL DHE SHPËRNDARJEN E KËTIJ  
INFORMACIONI TE PALËT E INTERESUARA**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 104 të ligjit 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” dhe në përputhje me ligjin nr.9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe midis Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një zone të përbashkët europiane të aviacionit”, si dhe në përputhje me urdhrin nr.68, datë 10.6.2011 “Për miratimin e rregullores për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e rregullores “Për integrimin në një bazë qendrore të informacionit për ngjarjet në aviacionin civil dhe shpërndarjen e këtij informacioni te palët e interesuara”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil dhe Organi Kombëtar i Investigimit të Incidenteve/Aksidenteve Ajrore për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE  
DHE TRANSPORTIT  
Sokol Olldashi**

**RREGULLORE**  
**PËR INTEGRIMIN NË NJË BAZË QENDRORE TË INFORMACIONIT PËR NGJARJET NË  
AVIACIONIN CIVIL DHE SHPËRNDARJEN E KËTIJ INFORMACIONI TE PALËT E  
INTERESUARA**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo rregullore parashikon masat për integrimin në një bazë qendrore të informacionit që lidhet me ngjarjet që ndikojnë në sigurinë ajrore dhe që shkëmbehet nga autoritetet kompetente shqiptare me shtetet anëtare të ZPEA-së, në përputhje me urdhrin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, nr.68, datë 10.6.2011 “Për miratimin e rregullores për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil” dhe shpërndarjen e këtij informacioni te palët e interesuara, me qëllimin për t’u siguruar këtyre palëve, informacionin e nevojshëm për të përmirësuar sigurinë ajrore në aviacionin civil.

**Neni 2**  
**Përkufizime**

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, përkufizimet e mëposhtme kanë këto kuptime:
  - 1.1 “Palë e interesuar” nënkupton çdo person fizik ose juridik, që është në pozitë për të marrë pjesë në përmirësimin e sigurisë ajrore në aviacionin civil, duke pasur akses në informacionin mbi



ngjarjet, në përputhje me neni 6/1 të urdhrit të ministrit nr.68, datë 10.6.2011 “Për miratimin e rregullores për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil” dhe që përfshihet në një nga kategoritë e palëve të interesuara, të listuara në aneksin I të kësaj rregulloreje.

1.2 “Pikë kontakti” nënkupton:

a) autoritetet kompetente sipas nenit 5/1 të urdhrit nr.68, datë 10.6.2011 “Për miratimin e rregullores për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil”;

b) Komisionin European.

### Neni 3

#### **Baza e informacionit**

1. Autoritetet kompetente shqiptare krijojnë një bazë të dhënash kombëtare mbi raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil të lidhura me sigurinë ajrore, për informacionin e mbledhur në bazat e të dhënave të tyre, siç parashikohet në nenin 5/2 dhe 5/3 të urdhrit të ministrit nr.68, datë 10.6.2011. Informacioni që përmban baza e të dhënave kombëtare, do të transferohet në bazën qendrore të informacionit, të krijuar dhe menaxhuar nga Komisioni European.

2. Autoritetet kompetente shqiptare duhet të bien dakord me Komisionin për protokollet teknike për përditësimin e bazës qendrore të informacionit, duke transferuar të gjithë informacionin përkatës, lidhur me sigurinë ajrore, që mbahet në bazën e të dhënave kombëtare. Kjo do të sigurojë që i gjithë informacioni përkatës, lidhur me sigurinë ajrore, që mbahet në bazën e të dhënave kombëtare, t'i bashkohet bazës qendrore të të dhënave.

3. Në përputhje me urdhrin e ministrit nr.68 datë 10.6.2011, çdo organ përgjegjës për aspektin rregullator të sigurisë ajrore në aviacion ose për hetimin e aksident-incidenteve, në aviacionin civil brenda ZPEA-së, do të mund të njihet *online* me të gjithë informacionin që përmban baza qendrore e të dhënave, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, përveç informacionit që identifikon direkt operatorin ose avionin subjekt të raportimit të ngjarjes.

4. Informacioni që mbetet konfidencial është emri, firma, shenja ose numri i fluturimit të operatorit, marka e regjistrimit ose numri serial i avionit. Në rastet kur ky informacion konsiderohet i nevojshëm për analizimin e sigurisë ajrore, duhet të kërkohet autorizim nga ai shteti i ZPEA-së, i cili ka dhënë informacionin.

### Neni 4

#### **Informacioni lidhur me hetimet**

Informacioni bazë mbi aksidentet dhe incidentet serioze duhet transferuar në bazën qendrore të të dhënave të Komisionit European, ndërkohë që investigimi është akoma në proces. Kur investigimi përfundon, duhet të shtohet në bazën qendrore i gjithë informacioni, përfshirë, kur është e mundur, edhe një përmbledhje në anglisht të raportit të hetimit përfundimtar.

### Neni 5

#### **Rishikimi**

Autoritetet kompetente duhet të rishikojnë çdo vit lidhjen e ngjarjeve të sigurisë ajrore me të dhënat e ruajtura dhe të shkëmbyera.

### Neni 6

#### **Kërkesat për informacion**

1. Palët e interesuara, që janë persona fizikë, të themeluara në ZPEA, të listuara sipas aneksit I të kësaj rregulloreje, duhet të adresojnë kërkesat për informacion pranë pikave të kontaktit të atij shteti, ku ata janë të licencuar ose kur nuk kërkohet licencë, të atij shteti ku ata ushtrojnë funksionet e tyre.

2. Palët e tjera të interesuara, të themeluara brenda ZPEA-së, duhet t'ua adresojnë kërkesat për informacion pikave të kontaktit të atij shteti ku ata kanë zyrë të regjistruar ose vendndodhjen zyrtare (selinë) ose në mungesë të tyre, vendndodhjen kryesore të biznesit të tyre.

3. Palët e interesuara, të themeluara jashtë ZPEA-së, duhet t'ia adresojnë kërkesën e tyre Komisionit Europian.

4. Lista e pikave të kontaktit botohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

5. Kërkesat duhet të dorëzohen duke përdorur formularët e miratuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil.

#### Neni 7

##### **Kërkesat speciale**

Çdo palë e interesuar, që ka dorëzuar një raport të veçantë, mund t'ia adresojë kërkesën për informacion lidhur me atë raport, drejtpërdrejt pikës së kontaktit që e ka marrë raportin.

#### Neni 8

##### **Vlerësimi i kërkesit**

1. Pika e kontaktit që merr një kërkesë duhet të kontrollojë që ajo të jetë bërë nga një palë e interesuar.

2. Nëse një palë e interesuar i adreson një pike kontakti, një kërkesë jashtë fushës së kompetencave të saj, atëherë palës së interesuar i sugjerohet të kontaktojë pikën e kontaktit kompetente.

#### Neni 9

##### **Vlerësimi i kërkesës**

1. Pika e kontaktit që merr një kërkesë duhet ta vlerësojë atë rast pas rasti, nëse kërkesa është e justifikuar dhe e argumentuar.

2. Nëse kërkesa pranohet, pika e kontaktit duhet të përcaktojë sasinë dhe nivelin e informacionit që duhet të japë. Informacioni do të kufizohet vetëm në atë që pikërisht kërkohet për qëllimet e kërkesit, pa rënë ndesh me nenin 8 të urdhrin të ministrit nr.68, datë 10.6.2011 "Për miratimin e rregullores për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil". Informacioni që nuk lidhet me pajisjet, operimet dhe fushën e aktivitetit të kërkesit, jepet vetëm në formë të papërpunuar, përveç rastit kur kërkesi paraqet një justifikim të detajuar.

3. Palët e interesuara të listuara në aneksin I (B) të kësaj rregulloreje, mund të pajisen vetëm me informacionin që lidhet me pajisjet, operimet ose fushën e aktivitetit të palës së interesuar.

#### Neni 10

##### **Vendimet e natyrës së përgjithshme**

Pika e kontaktit që merr një kërkesë nga palët e interesuara sipas listës në aneksin I (A) të kësaj rregulloreje, mund të marrë një vendim të përgjithshëm për t'i dhënë informacion rregullisht asaj pale të interesuar, me kusht që informacioni i kërkuar të ketë të bëjë me pajisjet, operimet dhe fushën e aktivitetit të vetë palës së interesuar.

#### Neni 11

##### **Përdorimi i informacionit dhe konfidencialitetit**

1. Kërkesi duhet të përdorë informacionin e marrë vetëm për qëllimin e specifikuar në formularin e kërkesës, që duhet të jetë në përputhje me objektivat e parashtruar në nenin 1 të urdhrin të ministrit nr.68, datë 10.6.2011 "Për miratimin e rregullores për raportimin e ngjarjeve në aviacionin



civil”. Kërkesi nuk duhet ta zbulojë informacionin e marrë pa një leje me shkrim nga dhënësi i këtij informacioni.

2. Kërkesi duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar konfidencialitetin e duhur për informacionin e marrë.

#### Neni 12

### **Regjistrimi i kërkesave**

Çdo pikë kontakti duhet të regjistrojë çdo kërkesë që i vjen dhe veprimet që ka kryer për të. Ky informacion i transmetohet Komisionit European, kur merret dhe/ose shqyrtohet një kërkesë.

Lista e përditësuar e kërkesave që vijnë dhe veprimet përkatëse të kryera nga pika të ndryshme të kontaktit të autorizuar dhe nga Komisioni vetë do t’u vihet në dispozicion pikave të kontaktit.

#### Neni 13

### **Mjetet e shpërndarjes së informacionit**

Pikat e kontaktit mund t’u japin informacion palëve të interesuara, në formë të shkruar ose duke përdorur mjete elektronike komunikimi.

Për arsye sigurie, palëve të interesuara nuk mund t’u ofrohet akses direkt në bazën e të dhënave që përmbajnë informacionin e marrë nga shtetet anëtare të BE-së, bazuar në nenin 6/1 të urdhrimit të ministrit nr.68, datë 10.6.2011 “Për miratimin e rregullores, për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil”.

#### ANEKSI I

### **LISTA E PALËVE TË INTERESUARA**

A. Lista e palëve të interesuara që mund të marrin informacion bazuar në vendimet rast pas rasti sipas nenit 9/2 të kësaj rregulloreje ose në bazë të një vendimi të përgjithshëm sipas nenit 10 të po kësaj rregulloreje.

Prodhuesit. Dizenjuesit dhe prodhuesit e avionit, motorëve, helikave dhe pjesëve e pajisjeve të avionëve; dizenjuesve dhe prodhuesve të sistemeve dhe përbërësve të Menaxhimit të Trafikut Ajror (MTA); dizenjuesve dhe prodhuesve të sistemeve dhe përbërësve të Shërbimeve të Lundrimit Ajror (SHLA), dizenjuesve dhe prodhuesve të sistemeve dhe pajisjeve të përdorura në pjesën ajrore të aerodromeve.

Mirëmbajtja. Organizatat e përfshira në mirëmbajtje ose kontroll të jashtëm fizik të avionëve, motorëve, helikave dhe pjesëve e pajisjeve të avionëve; me instalimin modifikimin, mirëmbajtjen, riparimin, revizionim, kontrollin e fluturimit ose inspektimin e shërbimet ndihmëse standarde të lundrimit ajror, ose mirëmbajtjen, revizionin e sistemeve të pjesës ajrore të aerodromeve, përbërësve dhe pajisjeve.

Operatorët. Linjat ajrore, operatorët e avionëve, shoqatat e linjave ajrore dhe operatorëve, operatorët e aerodromeve dhe shoqatat e operatorëve të aerodromeve.

Ofruesit e shërbimeve të lundrimit ajror dhe siguresit e funksioneve specifike të Menaxhimit të Trafikut Ajror.

Ofruesit e shërbimeve të aerodromëve. Organizatat e ngarkuara me shërbimet në tokë të aeroporteve, përfshirë furnizimin me lëndë djegëse, përgatitjen e dokumentacionit, ngarkimin, *de-icing* (pastrimin e akullit) dhe rimorkimin e avionëve në një aerodrom, sikundër edhe operimet e shpëtimit dhe zjarrfikëset, ose shërbimet e tjera emergjente.

Organizatrat e trajnimit në aviacion

Organizatrat e shteteve të huaja, joanëtare të ZPEA-së. Autoritetet shtetërore të aviacionit dhe organizatat e investigimit të aksidenteve nga shtetet e huaja, joanëtare të ZPEA-së

Organizatrat ndërkombëtare të aviacionit

Kërkim-studimi. Laboratorë kërkimi publikë ose privatë, qendra ose entitete, ose universitete të angazhuara në kërkime ose studime për sigurinë ajrore në aviacion.

B. Lista e palëve të interesuara që mund të marrin informacion, bazuar në vendimet rast pas rasti, në përputhje me nenin 9/3 të kësaj rregulloreje.

Pilotët (mbi baza personale)

Kontrollorët e trafikut ajror (mbi baza personale) dhe staf tjetër i MTA/SHLA-së që kryen detyra që lidhen me sigurinë ajrore.

Inxhinierë/teknikë/personel elektronik për sigurinë në trafikun ajror/menaxherë aviacioni (aerodromi) (mbi baza personale).

Organizata përfaqësuese profesionale të stafit që kryen detyra lidhur me sigurinë ajrore.

## ANEKSI II

### KËRKESË PËR MARRJEN E TË DHËNAVE NGA BAZA EUROPIANE E TË DHËNAVE TË NGJARJEVE

1. Emri:

Funksioni/pozicioni:

Shoqëria:

Adresa:

Tel.:

E-mail:

Data:

Natyra e biznesit:

Kategoria e palës së interesuar, së cilës i përkisnin (shiko aneksin I të kësaj rregulloreje):

2. Të dhënat e kërkuara (lutemi të jeni sa më specifike të jetë e mundur në kërkesën tuaj duke treguar periudhën/datën përkatëse për të cilën jeni i interesuar):

3. Arsyeja për kërkesën:

4. Qëllimi për të cilin do ta përdorni informacionin:

5. Data sipas së cilës kërkohen të dhënat:

6. Formulari i plotësuar duhet të dërgohet me postë zyrtare ose elektronike tek: (pika e kontaktit e autorizuar):

7. Aksesit të të dhënat:

Pika e autorizuar e kontaktit nuk është e detyruar të vërë në dispozicion çdo të dhënë të kërkuar. Këtë mund ta bëjë vetëm nëse është e sigurt që kërkesa është bërë në përputhje me urdhrin e ministrit nr.68, datë 10.6.2011 "Për miratimin e rregullores për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil". Kërkuesi merr përsipër që ai dhe organizata e tij do t'i përdorin të dhënat e marra vetëm për qëllimin që kanë përshkruar në pikën 4 të këtij aneksi.

Duhet marrë në konsideratë që të dhënat e siguruar në bazë të kësaj kërkesë, janë vënë në dispozicion vetëm për qëllimet e sigurisë ajrore dhe jo për qëllime të tjera, përfshirë përcaktimin e fajit ose të përgjegjësisë ose qëllime tregtare.

Kërkuesit nuk i lejohet t'i zbulojë askujt të dhënat e marra pa miratimin me shkrim të dhënësit të informacionit. Mosplotësimi i kërkesave të mësipërme mund të çojë në mohim të aksesit për informacion të mëtejshëm nga *data base* kombëtar i ngjarjeve, si dhe në ndonjë sanksion sipas rastit.

8. Data, vendi dhe firma.



**RREGULLORE  
PËR TRAJTIMIN E DËMEVE QË MBULOHEN NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË  
DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT**

*Miratuar me vendimin e autoritetit nr.53, datë 25.6.2009  
Ndryshuar me vendim bordi nr.168, datë 13.12. 2011*

Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 13 të ligjit nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, të pikës 3 të nenit 14 të ligjit 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Objekti**

1. Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat e trajtimit të dëmeve, që mbulohen nga kontrata e sigurimit:

- a) të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik;
- b) të përgjegjësishë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, për dëme shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti;
- c) të përgjegjësishë së pronarit ose të përdoruesit të avionit, për dëme shkaktuar palëve të treta dhe pasagjerëve nga përdorimi i këtij avioni;
- d) të përgjegjësishë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit lundrues, për dëme shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

2. Kjo rregullore është e detyrueshme për t’u zbatuar nga shoqëritë e sigurimit, Byroja Shqiptare e Sigurimit (BSHS), vlerësuesit e dëmeve në sigurime, strukturat e specializuara për trajtimin e dëmeve.

3. Termat e përdorur në këtë rregullore janë në kuptim të ligjit nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

**Neni 2  
E drejta për dëmshpërblim**

Çdo personi, të cilit i është shkaktuar një dëm nga përdorimi i mjetit të transportit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim për humbjet apo dëmtimet e pësuar që sipas rastit përbëhen nga:

- a) dëm pasuror:
  - i) dëm me pasojë vdekjen, dëmtime shëndetësore të përkohshme (të pjesshme/të plota) dhe të përhershme (të pjesshme/të plota);
  - ii) dëm material të lidhur me dëmtimin apo shkatërrimin e pronës;
- b) dëm jopasuror:
  - dëm biologjik;
  - dëm moral;
  - dëm ekzistencial.

**KREU II**  
**PROCEDURA E TRAJTIMIT TË DËMIT QË RRJEDH NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË**  
**DETYRUESHËM TË PËRGJEGJËSISË SË PRONARIT TË MJETIT MOTORIK**

**Neni 3**

**Paraqitja e kërkesës për dëmshpërblim**

1. Pala e dëmtuar ka të drejtë të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim:
  - a) te siguruesi përgjegjës i pronarit të mjetit të transportit, me të cilin është shkaktuar aksidenti;
  - b) te siguruesi i drejtpërdrejtë, në rast aksidenti të të dyja mjeteve motorike të identifikuar dhe të siguruara me kontratë sigurimi të detyrueshëm për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, në rast se midis shoqërive të sigurimit është lidhur një marrëveshje;
  - c) te shoqëritë e sigurimit të autorizuar si trajtues dëmsh, në rast se mjete i transportit shkaktar i aksidentit, është i pasiguruar apo i paidentifikuar.
2. Kërkesa për dëmshpërblim paraqitet me shkrim, ndërsa njoftimi i ngjarjes së sigurimit mund të bëhet me shkrim ose në mënyrë elektronike.
3. Kërkesa për dëmshpërblim është formular standard i shoqërisë së sigurimit, që i jepet palës së dëmtuar për ta plotësuar në rast dëmi. Shoqëria e sigurimit publikon formatin e kërkesës dhe në faqen zyrtare të internetit.
4. Paraqitja e kërkesës për dëmshpërblim bëhet brenda një periudhe prej 2 vjetësh nga data e ndodhjes së aksidentit, me përjashtim të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarëve të avionëve për dëme të shkaktuara palëve të treta.
5. Kërkesa për dëmshpërblim protokollohet dhe regjistrohet menjëherë në regjistrin elektronik të dëmeve.
6. Pala e dëmtuar nuk është e detyruar të përsërisë kërkesën për dëmshpërblim në rast se identifikohet shoqëria e sigurimit të mjetit shkaktar të aksidentit. Në këtë rast shoqëria e sigurimit që disponon kërkesën për dëmshpërblim e dërgon atë te shoqëria e sigurimit të mjetit shkaktar të dëmit, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e identifikimit të shoqërisë së sigurimit përgjegjëse. Kjo e fundit njofton palën e dëmtuar për marrjen e kërkesës për dëmshpërblim.

**Neni 4**

**Hapja e dosjes së dëmit**

1. Shoqëria e sigurimit bën regjistrimin e kërkesës për dëmshpërblim nga pala e dëmtuar dhe hap dosjen e dëmit.
2. Shoqëria e sigurimit hap dosje të veçantë të dëmit për çdo person, mjet transporti apo pronë të dëmtuar në një aksident.
3. Shoqëria e sigurimit është e detyruar:
  - a) të pajisë palën e dëmtuar me numrin e regjistrimit të kërkesës për dëmshpërblim. Ky numër shërben si vërtetim se pala e dëmtuar që ka paraqitur një kërkesë të tillë është regjistruar;
  - b) të pajisë palën e dëmtuar me një formular që përmban udhëzime, instruksione dhe listën e dokumenteve të nevojshme për plotësimin e dosjes së dëmit, si dhe çdo informacion tjetër që ka lidhje me trajtimin e dosjes së dëmit;
4. Siguruesi përgjegjës është i detyruar të trajtojë çdo kërkesë për dëmshpërblim që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.
5. Në momentin e hapjes, dosja e dëmit përmban:
  - a) elementet e identifikimit të dosjes (numri i dosjes, kodi i degës ku hapet dosja, data dhe vendi i aksidentit);
  - b) elementet e identifikimit të palës së dëmtuar (emër, mbiemër, adresa, nr. tel./ të dhëna për mjetin e dëmtuar/të dhëna identifikuese të pronës së dëmtuar, të dhëna për policën e sigurimit).





c) elementet e identifikimit të shkaktarit të dëmit (emër, mbiemër, adresa, nr. tel., elementet e policës së sigurimit, përfshirë dhe një kopje e saj).

#### Neni 5

### **Refuzimi i dëmshpërblimit**

1. Në rastin e refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, shoqëria e sigurimit është e detyruar të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar për refuzimin dhe shkaqet ligjore që çojnë në këtë refuzim.

2. Pavarësisht se kërkesa për dëmshpërblim është refuzuar, shoqëria e sigurimit fillon procedurën e trajtimit të dëmit, nëse pala e dëmtuar paraqet prova të reja të kërkuara nga shoqëria e sigurimit përpara përfundimit të afatit të parashkrimit parashikuar në Kodin Civil.

#### Neni 6

### **Afatet e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim**

Siguruesi përgjegjës është i detyruar të trajtojë kërkesën për dëmshpërblim dhe të njoftojë për masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim:

a) Për dëme jopasurore, brenda 90 ditëve nga data e plotësimit të dokumentacionit që shoqëron kërkesën për dëmshpërblim;

b) Për dëme pasurore, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim;

c) Për dëme materiale, ku shkalla e dëmtimit është e vogël dhe vlerësohet deri në 100.000 lekë, sipas parashikimeve të germës “a” të nenit 25 të kësaj rregulloreje, afati i trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim të jetë brenda 14 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim;

c/1) Njoftimi për masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim do të bëhet për çdo rast me shkrim, duke e dërguar në adresën e palës së dëmtuar nëpërmjet organeve postare, si letër rekomande;

d) Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në gerrat “a”, “b”, “c” të këtij neni, palës së dëmtuar i lind e drejta e përfitimit të interesit të pagueshëm për çdo ditë vonesë në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës.

#### Neni 7

### **Dokumentacioni i dosjes së dëmit**

Dokumentacioni i dosjes së dëmit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëme që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti përmban dokumente të përgjithshme dhe dokumente specifike të ndara:

a) për dëme shëndetësore;

b) për dëme materiale;

c) për dëme jopasurore.

#### Neni 8

### **Dokumentet për dëme shëndetësore**

Dokumentet për dëmet shëndetësore ndahen si më poshtë:

1. Dokumente të përgjithshme

a) Njoftimi/kërkesa e palës së dëmtuar për dëmshpërblim e regjistruar pranë shoqërisë së sigurimit

Pala e dëmtuar duhet të plotësojë të gjitha hapësirat e njoftim-kërkesës për dëmshpërblim, sipas formatit të miratuar nga shoqëria e sigurimit. Gjithashtu, të shpjegojë me hollësi rrethanat e ngjarjes.

b) Konfirmimi i mbulimit në sigurim nga shoqëria e sigurimit, të mjetit shkaktar të dëmit  
Konfirmimi i mbulimit në sigurim të mjetit shkaktar të dëmit, bëhet nga shoqëria e sigurimit dhe shoqërohet me policën e sigurimit të mjetit shkaktar të dëmit.

c) Formulari i vërtetimit miqësor të ngjarjes

Formulari i vërtetimit miqësor të ngjarjes (sipas formatit të miratuar nga autoriteti) duhet të paraqitet nga pala e dëmtuar. Formulari duhet të plotësohet me korrektësi dhe besnikëri nga pjesëmarrësit në aksident dhe të jetë i nënshkruar nga këto pjesëmarrës.

d) Procesverbali i konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore për ngjarjen

Procesverbali i konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore është dokumenti i cili përcakton përgjegjësinë e drejtuesit të mjetit shkaktar të dëmit.

Procesverbali i konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore konsiderohet i rregullt kur ai është lëshuar në përputhje me dispozitat e Kodit Rrugor.

e) Vendimi i prokurorisë për ngjarjen, kur në aksident rezultojnë vdekje dhe/ose plagosje të rënda

f) Vendimi i formës së prerë i gjykatës për përgjegjësitë në aksident, kur njëri nga drejtuesit e mjeteve motorike të përfshirë në aksident rezulton me vdekje ose plagosje të rëndë, ose vendimi i prokurorisë kur çështja është pushuar.

2. Dokumentet specifike

a) Certifikata familjare dhe letërnjoftimi/ID

Certifikata familjare e personit të dëmtuar, në rastin e paaftësisë së përhershme (pjesore ose totale) dhe të përkohshme, duhet të jetë sipas formatit zyrtar, e nënshkruar dhe e vulosur nga organi kompetent.

b) Vërtetimi i të ardhurave neto personale për tri vitet e fundit

Vërtetimi i të ardhurave neto personale për tre vitet e fundit (duke filluar nga data e aksidentit), i detajuar për çdo muaj duhet të lëshohet nga punëdhënësi dhe të konfirmohet nga organet e sigurimeve shoqërore ose tatim-taksa.

3. Për dëme shëndetësore me pasojë vdekje, përveç atyre të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, do të përfshihen edhe dokumentet e mëposhtme:

a) Skeda e vdekjes;

b) Certifikata e vdekjes;

c) Vendimi i gjykatës për përcaktimin e trashëgimtarëve të të ndjerit.

4. Për dëme shëndetësore me paaftësi të përhershme, përveç atyre të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, do të përfshihen edhe dokumentet e mëposhtme:

a) Raporti i paaftësisë së përhershme për punë, i cili duhet të shprehë në përqindje masën e paaftësisë, duke u bazuar në tabelën "Shkalla e humbjes së paaftësisë së përhershme në punë";

b) Radiografi/skaner/rezonancë manjetike/epikrizë/anamezë, fletështrimi dhe fletëdalja nga spitali dhe çdo dokument tjetër që ndihmon në vlerësimin e dëmit i lëshuar nga organet kompetente.

5. Për dëme shëndetësore me paaftësi të përkohshme, përveç atyre të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, do të përfshihet edhe raporti i paaftësisë së përkohshme, i cili duhet të jetë sipas modelarit tip, të lëshuar nga organi kompetent.

## Neni 9

### Dokumentet për dëme materiale

Dokumentet për dëmet materiale ndahen si më poshtë:

1. Dokumente të përgjithshme

a) Njoftimi/kërkesa e palës së dëmtuar për dëmshpërblim e regjistruar pranë shoqërisë së sigurimit

Pala e dëmtuar duhet të plotësojë të gjitha hapësirat e njoftimkërkesës për dëmshpërblim, sipas formatit të miratuar nga shoqëria e sigurimit. Gjithashtu, të shpjegojë me hollësi rrethanat e ngjarjes;



b) Konfirmimi i mbulimit në sigurim nga shoqëria e sigurimit, të mjetit shkaktar të dëmit  
Konfirmimi i mbulimit në sigurim të mjetit shkaktar të dëmit, bëhet nga shoqëria e sigurimit dhe shoqërohet me kopje të policës së sigurimit të mjetit shkaktar të dëmit;

c) Formulari i vërtetimit miqësor të ngjarjes

Formulari i vërtetimit miqësor të ngjarjes (sipas formatit të miratuar nga autoriteti) duhet të paraqitet nga pala e dëmtuar. Formulari duhet të plotësohet me korrektësi dhe besnikëri nga pjesëmarrësit në aksident dhe të jetë i nënshkruar nga këto pjesëmarrës.

d) Procesverbali i konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore për ngjarjen

Procesverbali i konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore konsiderohet i rregullt kur ai është lëshuar në përputhje me dispozitat e Kodit Rrugor.

e) Vendimi i prokurorisë për ngjarjen, kur në aksident rezultojnë vdekje dhe/ose plagosje të rënda.

f) Vendimi i formës së prerë i gjykatës (për përgjegjësitë në aksident, kur njëri nga drejtuesit e mjeteve motorike të përfshirë në aksident rezulton me vdekje ose plagosje të rëndë) ose vendimi i prokurorisë kur çështja është pushuar.

2. Dokumentet specifike

a) Dokumenti i pronësisë së mjetit ose objektit të dëmtuar;

b) Aktekspertimi i dëmit

Aktekspertimi i dëmit duhet të hartohet nga specialisti i shoqërisë së sigurimit në vendndodhjen e objektit të dëmtuar, në prani dhe të palës së dëmtuar ose të përfaqësuesit të tij.

Akti i ekspertimit duhet të hartohet brenda 10 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të aksidentit nga pala e dëmtuar.

Aktekspertimi i dëmit duhet të jetë i nënshkruar nga të dyja palët.

c) Foto të mjetit shkaktar të dëmit

Foto e mjetit shkaktar të dëmit, duhet të paraqesë në mënyrë të qartë targën dhe pjesët e dëmtuara si rrjedhojë e ngjarjes.

d) Foto të mjetit ose objektit të dëmtuar

Foto e mjetit ose e objektit të dëmtuar duhet të bëhet nga shoqëria e sigurimit që hap dosjen e dëmit gjatë procesit të ekspertimit. Dosja e dëmit duhet të përmbajë jo më pak se 3 (tri) foto të mjetit/objektit të dëmtuar në pozicione të ndryshme. Në foto duhet të paraqiten qartë pjesët e dëmtuara, si dhe në një nga fotot të pasqyrohet qartë pamja e përgjithshme e mjetit të dëmtuar së bashku me targën e tij.

#### Neni 10

##### **Dokumentet specifike për dëme jopasurore**

Dokumentet specifike për dëme jopasurore janë të njëjta me ato të parashikuara në pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 8 të kësaj rregulloreje.

#### Neni 11

##### **Dokumente të tjera të dosjes së dëmit**

Përveçsa është parashikuar në nenet 8 dhe 9 të kësaj rregulloreje, çdo dosje dëmi duhet të përmbajë edhe dokumentet e mëposhtme:

a) Aktvlerësimi i dëmit

Aktivlerësimi i dëmit kryhet nga vlerësuesi i dëmeve i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Në aktivlerësim do të përfshihen të gjitha elementet e domosdoshme që kërkojnë shpenzime.

b) Relacion përmbledhës, ku pasqyrohet i gjithë procesi, nga hapja e dosjes deri në përfundim. Në relacion duhet të përfshihet gjykimi për vërtetësinë e rastit të sigurimit.

c) Deklarata e pranimit të dëmshpërblimit, e cila do të shërbejë si provë për pranimin e vlerës së dëmshpërblimit nga pala e dëmtuar.

d) Dokumenti i zyrës postare, që vërteton marrjen nga i dëmtuari të njoftimit për masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim.

Përveçsa është parashikuar në këtë nen, dosja e dëmit mund të përmbajë edhe dokumente të tjera plotësuese që lidhen me trajtimin e dosjes së dëmit.

### KREU III METODOLOGJIA E PËRLLOGARITJES SË DËMIT SHËNDETËSOR

#### Neni 12

#### **Përlllogaritja e dëmit shëndetësor me pasojë vdekje**

Përlllogaritja e dëmit shëndetësor me pasojë vdekje bëhet sipas kësaj formule:

$$D = (T_{ap} - K_{avnv} \times T_{ap}) \times K_{shk} \times K_{mdp}$$

ku:

$D$  – dëmshpërblimi;

$T_{ap}$  – të ardhurat personale vjetore;

$K_{avnv}$  – koeficienti i të ardhurave për vetë nevojat e personit;

$K_{shk}$  – koeficienti i shumës së kapitalizuar;

$K_{mdp}$  – koeficienti i moshës së daljes në pension.

#### Neni 13

#### **Llogaritja e të ardhurave personale**

Si të ardhura personale do të konsiderohen:

Në rast se i ndjeri ka qenë në marrëdhënie punë, do të merret mesatarja e të ardhurave neto të tri viteve të fundit para ditës së aksidentit, të lëshuara nga punëdhënësi dhe të konfirmuara nga organet e sigurimeve shoqërore ose tatim-taksave.

Në rast se i ndjeri ka qenë pronar aktiviteti privat, do të merret deklarimi i të ardhurave neto të konfirmuara nga organet e tatim-taksave/sigurimeve shoqërore, e llogaritur si mesatare për tri vitet më të fundit të punës.

Në rast se i ndjeri nuk ka qenë në marrëdhënie punë, do të konsiderohet vlera bruto e pagës minimale zyrtare në momentin e ndodhjes së aksidentit.

Në qoftë se i ndjeri ka qenë punëmarrës te një punëdhënës i huaj apo shqiptar jashtë vendit, si e ardhur do të merret paga neto e punës e vitit të fundit apo certifikata e lëshuar për këtë qëllim nga punëdhënësi, e konfirmuar nga organet kompetente vendore.

Shuma e pensionit që ka marrë vitin e fundit, në qoftë se i ndjeri ka qenë në pension.

#### Neni 14

#### **Koeficientet**

1. Përqindja e të ardhurave për nevojat e vetë personit ( $K_{vaup}$ ) do të jetë si më poshtë:

a) Kur i ndjeri ka pasur në familje tre dhe mbi tre persona (pa të ndjerin), pjesa që do të zbritet është 30% e të ardhurave;



b) Kur i ndjeri ka pasur në familje dy persona (pa të ndjerin), pjesa që do të zbritet është 40% e të ardhurave;

c) Kur i ndjeri ka pasur në familje një person (pa të ndjerin), pjesa që do të zbritet është 50% e të ardhurave;

d) Kur i ndjeri ka qenë i vetëm në familje, do të paguhet vetëm shpenzimet e varrimit. Këto shpenzime i paguhet subjektit që ka kryer shërbimet funerale ose shtetit;

e) Kur i ndjeri është nën moshën 16 vjeç, trashëgimtarët e tij do të dëmshpërblehen në shumën fikse prej 1,000,000 lekësh.

f) Në se trashëgimtarët e të ndjerit janë të mitur, dëmshpërblimi do të depozitohet në emër të tyre në një bankë të nivelit të dytë e cila operon në Republikën e Shqipërisë dhe shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë me shkrim menjëherë, përfituesin e mësipërm.

2. Koeficienti i shumës së kapitalizuar (KSHK) paraqitet në tabelën nr.1 “Koeficientet e llogaritjes së shumës së kapitalizuar”, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

3. Koeficienti i moshës së daljes në pension.

Në rast se i ndjeri ka qenë në marrëdhënie pune, koeficienti i moshës së daljes në pension do të merret 0.90.

4. Koeficienti i moshës së daljes në pension për të papunët, do të merret 0.80.

#### Neni 15

#### Shpenzimet e varrimit

Në vlerën e dëmshpërblimit me pasojë vdekjen, do të shtohen edhe shpenzimet e varrimit, në shumën fikse prej 250,000 lekësh.

#### Neni 16

#### Përlllogaritja e dëmit shëndetësor me pasojë paaftësinë e përhershme në punë (përkeqësim shëndeti)

Përlllogaritja e dëmit shëndetësor me pasojë paaftësinë e përhershme në punë, bëhet sipas kësaj formule:

$$D = T_{ap} \times K_{shk} \times K_{mdp} \times K_{hap}$$

Ku:

$D$  – dëmshpërblimi;

$T_{ap}$  – të ardhurat personale vjetore;

$K_{shk}$  – koeficienti i shumës së kapitalizuar;

$K_{mdp}$  – koeficienti i moshës së daljes në pension;

$K_{hap}$  – koeficienti i humbjes së aftësisë për punë.

#### Neni 17

#### Llogaritja e të ardhurave personale dhe koeficientët e përdorura në llogaritje

1. Të ardhurat personale, koeficienti i shumës së kapitalizuar dhe koeficienti i moshës së daljes në pension janë të njëjta me përcaktimet e dhëna në nenet 13 dhe 14.

2. Për të dëmtuarit e mitur (deri në 16 vjeç) dhe të papunët, si e ardhur vjetore do të merret vlera bruto e pagës minimale zyrtare në momentin e ndodhjes së aksidentit.

3. Koeficienti i humbjes së aftësisë për punë ( $K_{hap}$ ) jepet nga KMCAP (Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë), duke u mbështetur në tabelën nr.2 (shkalla e humbjes së aftësisë për punë), bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

4. Nëse nuk ka ndonjë parashikim tjetër në legjislacionin në fuqi, kur i dëmtuari në momentin e ndodhjes së aksidentit është i papunë, koeficienti i humbjes së aftësisë për punë jepet nga Komisioni Mjekësor i ngritur pranë BSHS-së.

5. Për dëmtimet funksionale, vendimi i KMCAP-së do të konsiderohet i vlefshëm pas kalimit të afatit 6-mujor nga dita e aksidentit.

6. Për të dëmtuarit nën 12 vjeç, për efekt llogaritjeje, të merret koeficienti i llogaritjes së shumës së kapitalizuar që i korrespondon moshës 12 vjeç.

7. Për të dëmtuarit mbi 80 vjeç, për efekt llogaritjeje, të merret koeficienti i llogaritjes së shumës së kapitalizuar që i korrespondon moshës 80 vjeç.

#### Neni 18

#### Vlera shtesë e dëmit me pasojë paaftësinë e përhershme për punë

Vlerës së dëmshpërblimit të llogaritur sipas nenit 16, do t'i shtohen edhe shpenzimet spitalore e farmaceutike të kryera nga i dëmtuari brenda periudhës së paaftësisë dhe të vërtetuar me dokumente të rregullta.

#### Neni 19

#### Përlllogaritja e dëmit shëndetësor me pasojë paaftësinë e përkohshme në punë (dëmtim shëndetësor)

1. Humbja e përkohshme e aftësisë për punë përcaktohet nga raportet mjekësore (modelarë), për një periudhë deri 6 muaj.

2. Përveçsa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni, do të konsiderohen humbje e përkohshme e aftësisë për punë edhe rastet kur vendimi i KMCAP-së përcakton paaftësi të përkohshme për një periudhë të caktuar.

Edhe në këtë rast, përlllogaritja e dëmit shëndetësor bëhet sipas parashikimeve të këtij neni sipas periudhës së paaftësisë së përcaktuar në raportit të paaftësisë së përkohshme, periodikisht me baza vjetore, në varësi të vendimit të KMCAP-së.

3. Kur i dëmtuari është i punësuar në sektorin privat apo publik, dëmshpërblimi mujor llogaritet si diferencë midis pagës të muajit të fundit para aksidentit dhe pagës që përftohet nga raportet mjekësore.

4. Kur i dëmtuari është pa punë, dëmshpërblimi i përfitur sipas pikës 1 të këtij neni, llogaritet me formulën e mëposhtme:

$$D = \frac{P_{mz} \cdot x P_{rd}}{d}$$

ku:

$D$  – dëmshpërblimi;

$P_{mz}$  – paga minimale zyrtare;

$P_{rd}$  – periudha e raporteve në ditë;

$d$  – 21 ditë.

5. Kur i dëmtuari është pa punë, dëmshpërblimi i përfitur sipas pikës 2 të këtij neni, llogaritet me formulën e mëposhtme:



$$D = P_{mz} \cdot x P_{pp}$$

ku:

$D$  – dëmshpërblimi;

$P_{mz}$  – paga minimale zyrtare;

$P_{pp}$  – periudha e paaftësisë së përkohshme

6. Përveç dëmshpërblimit të shprehur në pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni, të dëmtuarit do t'i paguhet edhe shpenzimet spitalore e farmaceutike të kryera nga ai brenda periudhës së paaftësisë së përkohshme.

7. Kur i dëmtuari është i mitur (nën 16 vjeç), ose pensionist si dëmshpërblim do të konsiderohet pagesat e shpenzimeve spitalore e farmaceutike të kryera nga ai.

#### KREU IV

#### TRAJTIMI I TË DËMTUARVE ME SHËRBIME MJEKËSORE JASHTË VËNDIT

##### Neni 20

#### Procedurat e kurimit të të dëmtuarve jashtë vendit

1. Në kuptim të kësaj rregulloreje, do të konsiderohen të dëmtuar që kurohen jashtë vendit të gjithë ata të dëmtuar që përfitojnë nga ligji nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe që rekomandohen për kurim jashtë vendit nga Komisioni Mjekësor Zyrtar i ngritur për këtë qëllim nga Ministria e Shëndetësisë.

2. Komisioni Mjekësor Zyrtar arsyeton mbi mundësinë e kurimit të të dëmtuarit brenda apo jashtë vendit dhe shprehet për rastet kur është i nevojshëm kurimi jashtë vendit, duke rekomanduar edhe klinikën që do të përdoret.

3. Për çdo të dëmtuar, shoqëria e sigurimit duhet të bjerë dakord rast pas rasti me klinikën që merr përsipër kurimin, për çmimin për çdo ditë qëndrimi të të dëmtuarit dhe shoqëruesin e tij, llojin e ndërhyrjeve, numrin e tyre, çmimin për çdo ndërhyrje dhe afatin e kurimit.

4. Klinika kuruese do të paguhet nga shoqëria që ka siguruar mjetin shkaktar të dëmit, sipas faturave të paraqitura. Këto shpenzime konsiderohen dëmshpërblim për të dëmtuarin.

5. Nëse i dëmtuari edhe pas kurimit jashtë vendit rezulton me paaftësi të përhershme për punë, për dëmshpërblim të mëtejshëm të tij do të vepohet sipas rregullave mbi “Llogaritjen e dëmshpërblimit me pasojë paaftësi e përhershme për punë”.

6. Kur të dëmtuarit kurohen jashtë vendit pa miratimin me shkrim sipas procedurave të përmendura më lart, dëmshpërblimi do të llogaritet sipas nenit 16 dhe në vijim “Përlllogaritja e dëmshpërblimit me pasojë paaftësi e përhershme për punë”.

Përjashtim konsiderohen rastet, vetëm kur personi i dëmtuar për shkaqe shëndetësore urgjente që rrezikon jetën e tij, duhet të kurohet jashtë vendit.

#### KREU V

#### METODOLOGJIA E PËRLLLOGARITJES SË DËMIT MATERIAL

##### Neni 21

#### Kategorizimi i mjeteve

Mjetet motorike në varësi të vitit të prodhimit ose vënies në qarkullim, kategorizohen si më poshtë:

Grupi i parë: Përfshihen mjete të prodhuara ose të vëna në qarkullim në interval kohor ushtrimor 4 (katër) vjet përpara ditës së dëmit;

Grupi i dytë: Përfshihen mjete të prodhuara ose të vëna në qarkullim në interval kohor ushtrimor 6 (gjashtë) vjet përpara atij të grupit të parë;

Grupi i tretë: Përfshihen mjete të prodhuara ose të vëna në qarkullim në intervalin kohor përpara grupit të dytë.

#### Neni 22

### Dokumentacioni që përcakton grupin e mjetit

1. Dokumentacioni që përcakton grupin e mjetit, është:

- a) leje e qarkullimit të mjetit;
- b) certifikata e pronësisë së mjetit.

2. Dokumentacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni duhet të paraqitet: origjinal ose fotokopje e noterizuar.

3. Në mungesë të dokumentacionit të përmendur në pikën 1, përcaktimi i grupit do të bëhet nëpërmjet botimeve të fundit të katalogëve ndërkombëtarë të njohur.

#### Neni 23

### Vlerësimi i dëmit material

1. Mënyra e llogaritjes së vlerës së dëmshpërblimit do të zgjidhet në funksion të amortizimit të mjetit motorik, vlerës aktuale dhe gjendjes teknike të tij, mundësisë për sigurimin e pjesëve të këmbimit, nivelit të kërkesave për riparim etj.

2. Pas kryerjes së ekspertimit të dëmit dhe vlerësimit të mjetit para ngjarjes, kryhet vlerësimi i dëmit duke e pasqyruar atë në aktvlerësim dëmi. Aktvlerësimi detyrimisht përmban:

Në pjesën e parë

- Emrin e përfituesit të dëmit;
- Emrin e shkaktarit të dëmit në momentin e aksidentit;
- Policën e sigurimit të mjetit shkaktar të dëmit.

Në pjesën e dytë

Të gjitha elementet që pasqyrohen në këtë pjesë, plotësohen gjatë ekspertimit fizik të mjetit të dëmtuar, me qëllim që të bëhet më pas krahasimi me dokumentacionin përkatës që i korrespondon mjetit.

Në pjesën e tretë

Përshkruhen dëmtimet dhe numri i pjesëve të dëmtuara dhe shënohet emërtimi i pjesës, gjendja e automjetit dhe mënyra e riparimit, në varësi të shkallës së dëmtimit, duke i ndarë në:

- a) pjesë për ndërrim;
- b) pjesë për riparim ( L, M, V);
- c) pjesë për kontroll dhe adoptim.

3. Si në rastin e dëmtimit pjesor apo shkatërrimit total të pronës, dëmshpërblimi material në asnjë rast nuk duhet të tejkalojë vlerën aktuale të pronës së dëmtuar.

4. Në vlerën e dëmshpërblimit duhet të përfshihen dhe shpenzimet për transportin e mjetit motorik, shpenzime ruajtjeje dhe shpenzime gjyqësore apo noteriale.

5. Shoqëria e sigurimit është e detyruar t'i ofrojë palës së dëmtuar dëmshpërblim në vlerë monetare ose riparim të mjetit në servis.

6. Elementet e detajuara të vlerësimit të dëmit material përcaktohen në manualët e dëmeve të shoqërive. Manualët e shoqërive dhe çdo ndryshim i kryer në to duhet të depozitohen në Autoritetin e Mbikëqyrjes.





#### Neni 24

##### **Ndërrimi i pjesëve të dëmtuara**

1. Për dëmtime, për të cilat nuk ekzistojnë mundësitë teknike për një riparim cilësor dhe ekonomik, do të kryhet ndërrimi i pjesëve ose i strukturës së mjetit motorik.
2. Nëse mjete nuk ka dëmtime të mëdha, ndërrohen:
  - a) pjesët e dëmtuara, të cilat ndikojnë në sigurinë e automjetit;
  - b) pjesët e dëmtuara, të cilat me riparimin e tyre, nuk mund të kthehen në gjendjen e mëparshme nga ana estetike;
  - c) struktura të pjesshme, të cilat duhen të jenë në harmoni me udhëzimet e prodhuesit.
3. Nëse, si rezultat i aksidentit, ka thyerje të xhamit të mjetit, duhet të përcaktohet saktësisht lloji i xhamit, cilësia e tij, mënyra e ngjitjes, si dhe cilësi të tjera të cilat kanë rëndësi në vlerësimin real të dëmit.
4. Nëse për shkak të dëmtimeve të mëdha, është i domosdoshëm ndërrimi i pjesëve, të cilat (edhe të ngjashme) nuk gjenden në treg, me pëlqimin e palës së dëmtuar, mund të bëhet riparimi i pjesës së dëmtuar, duke kërkuar dhe një kohë shtesë për këtë riparim.

#### Neni 25

##### **Pjesët për riparim**

1. Pjesët e dëmtuara të mjetit riparohen, me kusht që të ruhet siguria e mjetit, si dhe riparimi të rezultojë më ekonomik sesa ndërrimi i këtyre pjesëve.
2. Shkalla e dëmtimit të mjetit ndahet në:
  - a) Dëmtime të vogla (V) konsiderohen dëmtime në pjesët e jashtme pa deformime të mëdha, pjesët e dëmtuara mund të riparohen lehtë me pak orë punë dhe materiale, si dhe gjenden në pozicione të përshtatshme për t'u riparuar.
  - b) Dëmtime të mesme (M) konsiderohen dëmtime të cilat janë të dukshme dhe të theksuara dhe gjenden në pozicione të papërshtatshme për t'u riparuar.
  - c) Dëmtime të larta (L) konsiderohen dëmtime me deformime të mëdha dhe gjenden në vende jashtëzakonisht të papërshtatshme për riparim.

#### Neni 26

##### **Pjesët për kontroll dhe adoptim**

1. Nëse dëmtimi i mjetit, si pasojë e aksidentit ndikon në rregullimin gjeometrik të pjesëve të dëmtuara ose ndërlydhëse të mjetit është i nevojshëm kontrolli konkret i tij dhe veçanërisht:
  - a) gjeometria e rrotave;
  - b) gjeometria e pikave matëse të karrocërisë, shasisë etj.;
  - c) sistemi i drejtimit, rezervuari i karburantit etj.

#### Neni 27

##### **Riparimi i mjetit në servis**

1. Riparimi në servis aplikohet në rastet kur mjete i dëmtuar autorizohet, me pëlqimin e palës së dëmtuar, për t'u riparuar në servis.
2. Autorizimi për riparimin e mjeteve në servis jepet vetëm nga personi i autorizuar i shoqërisë së sigurimit.
3. Riparimi i mjetit të dëmtuar kryhet vetëm në servise të regjistruara pranë organeve tatimore, me të cilët është lidhur më parë aktmarrëveshja përkatëse nga shoqëria e sigurimit.

4. Ekspertimi i mjetit të dëmtuar bëhet i përbashkët ndërmjet ekspertit të shoqërisë së sigurimit, përfaqësuesit të servisit dhe palës së tretë/të dëmtuarit dhe firmoset prej tyre.
5. Secila palë ka të drejtë të pajiset me një kopje të aktekspertimit të dëmit.
6. Riparimi konsiderohet i përfunduar kur pala e tretë/i siguruari nënshkruan formularin “Deklarimi i pranimit të riparimit të mjetit”.
7. Dorëzimi i mjetit nga ana teknike, para dhe pas riparimit, bëhet me procesverbal në prani të përfaqësuesit të servisit, palës së tretë/të siguarit.
8. Dëmshpërblimi i paguhet palës së tretë/të siguarit, përfaqësuesit ligjor të saj ose servisit të autorizuar, kur kjo bëhet me kërkesë apo me miratim me shkrim të palës së tretë/të siguarit.
9. Lëshimi i faturës nga servisi bëhet pas pranimit pa pretendime të mjetit të riparuar nga pala e tretë/i siguruari.

## KREU VI METODOLOGJIA E PËRLLOGARITJES SË DËMIT JOPASUROR

### Neni 28 Dëmi jopasuror

1. Çdo personi të cilit i është shkaktuar një dëm nga përdorimi i mjetit të transportit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 22 dhe nenin 50 të ligjit nr.10 076, datë 12.2.2009, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim për dëme jopasurore.
2. Dëmi jopasuror përbëhet nga:
  - a) dëmi biologjik;
  - b) dëmi moral;
  - c) dëmi ekzistencial.

### Neni 29 Dëmi biologjik

1. Dëmi biologjik përbën në thelb cenimin e së mirës së shëndetit, të integritetit fizik dhe/ose psikik të njeriut dhe që ka një ndikim negativ në aktivitetin jetësor të përditshëm, në aspektin dinamik dhe ndërpersonal të jetës së palës së dëmtuar, pavarësisht kthimit të mundshëm të kapacitetit të tij për të siguruar të ardhura.
2. Dëm biologjik përfiton personi i dëmtuar sipas shkallës së paaftësisë së përhershme, i përcaktuar nga raporti i komisionit të ekspertëve mjeko-ligjorë, si dhe trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit në rastin me pasojë vdekje.
3. Dëmi biologjik për dëmtimin e përhershëm përcaktohet, referuar shkallës së dëmtimit dhe moshës së palës së dëmtuar dhe llogaritet për çdo 10% shkallë të paaftësisë, si më poshtë:

Deri në moshën 20 vjeç:	
a) deri në 30%	90,000 lekë
mbi 30%	100,000 lekë;
Prej moshës 20 vjeç deri në 30 vjeç:	
b) deri në 30%	75,000 lekë
mbi 30%	90,000 lekë;
Prej moshës 30 vjeç deri në 50 vjeç:	
c) deri në 30%	45,000 lekë
mbi 30%	75,000 lekë;
Mbi moshën 50 vjeç:	
d) deri në 30%	30,000 lekë
mbi 30%	50,000 lekë.



4. Në rastin me pasojë vdekjen, trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit do të përfitojnë në mënyrë proporcionale vlerën që do të përfitonte i ndjeri në rast mbijetese, sipas vlerave të mësipërme me shkallë paaftësie 100%.

#### Neni 30

##### **Dëmi moral dhe dëmi ekzistencial**

1. Dëmi moral është shfaqje e brendshme e turbullimit të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore individuale dhe e familjarëve të të dëmtuarit.

2. Dëmi ekzistencial është cenimi i të drejtave të personalitetit të njeriut, duke dëmtuar në mënyrë të përhershme shprehjen e të dëmtuarit si njeri, ose të familjarëve të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtarinë e zakonshme të tij si në cilësinë e jetës, ashtu dhe në marrëdhëniet personale dhe familjare.

3. Dëmin moral dhe dëmin ekzistencial nga vdekja, paaftësia e pjesshme e përhershme apo paaftësia totale e përhershme, e përfitojnë personi i dëmtuar dhe/ose familjarët e personit të dëmtuar.

4. Në rrethin e personave familjarë përfshihen: bashkëshort, fëmijë, prind, si dhe personi që vërteton ekzistencën e bashkëjetesës së qëndrueshme ndjesore dhe ekonomike me personin e dëmtuar.

5. Vlera e dëmit moral dhe ekzistencial për paaftësinë e pjesshme të përhershme do të llogaritet për çdo 10% shkallë paaftësie në masën 100,000 lekë; nga kjo vlerë familjarët e personit të dëmtuar nuk mund të përfitojnë më shumë se 1/3 e vlerës së përfitimit.

6. Vlera e dëmit moral dhe ekzistencial që përfitojnë trashëgimtarët e të ndjerit llogaritet jo më shumë se 1/2 e dëmit moral që do të përfitonte ai dhe familjarët e tij nëse personi do të mbijetonte me paaftësi totale të përhershme.

7. Vlera e dëmit moral që përfiton personi i dëmtuar në rastin e dëmtimit total të përhershëm të shëndetit (shkalla e paaftësisë 100%), llogaritet nga 1/2 deri në dyfishin e dëmit biologjik sipas moshës përkatëse; nga kjo vlerë familjarët e personit të dëmtuar nuk mund të përfitojnë më shumë se 1/3 e vlerës së përfitimit.

8. Vlera e dëmit ekzistencial që përfiton personi i dëmtuar në rastin e dëmtimit total të përhershëm të shëndetit (shkalla e paaftësisë 100%), llogaritet nga 1/2 deri në 3/2 e dëmit biologjik sipas moshës përkatëse; nga kjo vlerë, familjarët e personit të dëmtuar, nuk mund të përfitojnë më shumë se 1/3 e vlerës së përfitimit.

#### Neni 31

##### **Kufiri i mbulimit të përgjegjësive**

1. Kufiri i mbulimit të përgjegjësive ndaj palëve të treta, pavarësisht nga përlllogaritjet e bëra sipas neneve 29 dhe 30 të kësaj rregulloreje, nuk duhet të tejkalojnë në asnjë rast limitet e përcaktuara në nenin 26 të ligjit nr.10 076, datë 12.2.2009.

2. Në rast se ka disa palë të dëmtuara nga një ngjarje dhe vlera totale e dëmtimit tejkalon shumat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, të drejtat e palëve të dëmtuara ndaj shoqërisë së sigurimit zvogëlohen në mënyrë përpjesëtimore.

#### KREU VII

##### **DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR TRAJTIMIN E DËMIT QË RRJEDH NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË PASAGJERËVE NË TRANSPORTIN PUBLIK**

#### Neni 32

##### **E drejta për dëmshpërblim**

1. Pasagjeri i përfshirë në një aksident ose përfituesi, në rastin kur pasagjeri vdes, ka të drejtë, sipas kushteve të kontratës së sigurimit, të kërkojë që shoqëria e sigurimit, me të cilin është lidhur kontrata e sigurimit, të paguajë detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë drejtpërdrejt tek ai.

2. Dëshmepërblimi për humbjet e pësuar në rast aksidenti përfshin:
- dëm shëndetësor me pasojë vdekje;
  - dëm shëndetësor për paaftësi të përhershme.

Neni 33

**Kërkesa për dëshmepërblim**

- Në rast të ndodhjes së aksidentit, i siguruari/pasagjeri i dëmtuar ose përfituesi i tij, në rastin kur pasagjeri vdes, është i detyruar të njoftojë shoqërinë e sigurimit, me të cilën është lidhur kontrata e sigurimit.
- Njoftimi bëhet brenda 10 ditëve nga data e ndodhjes së aksidentit ose nga momenti që pala e dëmtuar ka pasur mundësi të dërgojë njoftimin.
- Kërkesa për dëshmepërblim paraqitet me shkrim ose në mënyrë elektronike dhe duhet të tregojë vendin, ditën, orën, shkaku të aksidentit, mjetin e transportit, si dhe itinerarin e udhëtimit.
- Shoqëria e sigurimit është e detyruar të pranojë dhe të regjistrojë kërkesën për dëshmepërblim.
- Nëse pronari i një mjeti motorik nuk ka lidhur kontratë për sigurimin e pasagjerëve, sipas dispozitave të ligjit nr.10 076, datë 12.2.2009 dhe aksidenti ka ndodhur, pasagjeri ose personi përfitues ka të drejtë të kërkojë pagesën e shumës së siguruar nga fondi i kompensimit.

Neni 34

**Afatet e trajtimit të kërkesës për dëshmepërblim**

Siguruesi është i detyruar të trajtojë kërkesën për dëshmepërblim, të bëjë verifikimet e nevojshme dhe të njoftojë për masën e dëshmepërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëshmepërblim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për dëshmepërblim.

Neni 35

**Dokumentacioni i dosjes së dëmit**

- Dosja e dëmit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik përmban:
  - Njoftimin/kërkesën e të siguarit/pasagjerit të dëmtuar ose përfituesit të tij, në rastin kur pasagjeri vdes, për dëshmepërblim sikurse përcaktohet në nenin 33 “Kërkesa për dëshmepërblim” të kësaj rregulloreje;
  - Certifikatën mjekësore të plotësuar dhe të lëshuar nga mjeku që ka bërë vizitën e parë mjekësore të pasagjerit të dëmtuar;
  - Raportin mjekësor mbi shkallën e paaftësisë. Raporti i paaftësisë së përhershme për punë, i cili duhet të shprehë në përqindje masën e paaftësisë, duke u bazuar në tabelën “Shkalla e humbjes së paaftësisë së përhershme në punë”;
  - Radiografi/skaner/rezonancën manjetike/epikrizë/anamezë, fletështrimin dhe fletëdaljen nga spitali dhe çdo dokument tjetër që ndihmon në vlerësimin e dëmit të lëshuar nga organet kompetente;
  - Dokumentin e identifikimit të personit;
  - Biletën e udhëtimit/kartë ose ndonjë dokument tjetër në origjinal që provon se pala e aksidentuar ka qenë pasagjer;
  - Konfirmim me shkrim nga policëmbajtësi, se personi i dëmtuar ka qenë pasagjer i tij. Policëmbajtësi është i detyruar të vërtetojë se i aksidentuari ka qenë pasagjer duke udhëtuar me mjetin e tij, pavarësisht nga fakti nëse personi i dëmtuar ishte pajisur me biletë apo udhëtonte pa pagesë për shkak të një statusi ligjor;
  - Konfirmimin e mbulimit në sigurim nga shoqëria e sigurimit;
  - Raport i Policisë Rrugore për ngjarjen, nëse ka;



- j) Certifikatën e vdekjes (në rast të vdekjes së pasagjerit);
- k) Skedën e vdekjes;
- l) Vendimin e Gjykatës për përcaktimin e trashëgimtarëve të të ndjerit;
- m) Deklarata e pranimit të dëmshpërblimit, e cila do të shërbejë si provë për pranimin e vlerës së dëmshpërblimit nga pala e dëmtuar.

2. Përveçsa është parashikuar pikën 1 të këtij neni, dosja e dëmit mund të përmbajë edhe dokumente të tjera plotësuese që lidhen me trajtimin e dosjes së dëmit.

#### Neni 36

### **Përlllogaritja e dëmit me pasojë vdekje**

1. Në rastin e vdekjes së pasagjerit si pasojë e një aksidenti të mbuluar nga sigurimi i detyrueshëm i pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, shoqëria e sigurimit është e detyruar të paguajë dëmshpërblimin në masën e shumës së sigurimit të përcaktuar në pikën 1 dhe germën “a” të pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

2. Kur i ndjeri ka qenë i vetëm në familje, paguhen vetëm shpenzimet e varrimit. Këto shpenzime i paguhen subjektit që ka kryer shërbimet funerale ose shtetit.

3. Nëse trashëgimtarët e të ndjerit janë të mitur, dëmshpërblimi do të depozitohet në emër të tyre në një bankë të nivelit të dytë, që operon në Republikën e Shqipërisë dhe shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë me shkrim menjëherë përfituesin e mësipërm.

#### Neni 37

### **Përlllogaritja e dëmit shëndetësor me pasojë paaftësinë e përhershme në punë**

1. Në rastin e paaftësisë së përhershme të pasagjerit, si pasojë e një aksidenti të mbuluar nga sigurimi i detyrueshëm i pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, shoqëria e sigurimit është e detyruar të paguajë dëmshpërblimin sipas përlllogaritjes së parashikuar në nenet 16, 17 dhe 18 të kësaj rregulloreje.

2. Masa e dëmshpërblimit e përlllogaritur sipas pikës 1 të këtij neni, nuk duhet të jetë më e madhe se shuma e sigurimit e përcaktuar në pikën 1 dhe germën “b” të pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

## KREU VIII

#### Neni 38

### **Trajtimi dhe pagesa e dëmeve nga fondi i kompensimit**

1. Dosjet e dëmeve, objekt i fondit të kompensimit, sipas parashikimeve të neneve 21, 29, 30, 36 të ligjit nr.10 076, datë 12.2.2009, trajtohen nga Byroja Shqiptare e Sigurimit.

2. Byroja Shqiptare e Sigurimit mund t’ua delegojë shqyrtimin dhe pagesën e dëmit një shoqërie sigurimi sipas kriterëve të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, e autorizuar si trajtues dëmsh ose një strukturë e specializuar për trajtimin e dëmeve.

3. Trajtimi i dosjeve të dëmit, sipas pikës 1 të këtij neni, kryhet në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

4. Të gjitha dosjet, objekt i fondit të kompensimit, brenda 10 ditëve kalendarike nga dita e plotësimit të dokumentacionit dërgohen për miratim dhe pagesë pranë Byrosë.

5. Miratimi i dosjeve të dëmeve objekt i fondit të kompensimit, kryhet nga një komision i ngritur për këtë qëllim pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit.

6. Pagesa e dëmeve objekt i fondit të kompensimit, kryhet nga Byroja ose nga shoqëria e sigurimit trajtuese e dëmit, nëse midis shoqërisë së sigurimit dhe byrosë është lidhur një marrëveshje.

Në marrëveshje përcaktohen afatet dhe procedurat e pagesës, si dhe termat e rimbursimit nga Byroja.

## KREU IX

### Neni 39

#### **Trajtimi i dosjeve të dëmeve të shkaktuara nga automjete me targa të huaja**

1. Byroja miraton dhe paguan të gjitha kërkesat për dëmshpërblim, që rrjedhin nga aksidentet e ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë të shkaktuara nga automjete me targa të huaja të pajisura me “Karton jeshil”, me përjashtim të rasteve kur siguruesi që ka lëshuar “Kartonin jeshil”, ka emëruar një korrespondent për trajtimin e dëmeve në zbatim të nenit 4 të rregullores së brendshme të këshillit të byrove.

2. Për të gjitha rastet për të cilat nuk është emëruar një korrespondent, Byroja trajton dhe miraton dosjen e dëmit, me strukturën ekzekutive të saj në përputhje me rregulloren e brendshme të këshillit të byrove, si dhe vendimet dhe rekomandimet e Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Byrove.

3. Kërkesat për dëmshpërblim do të trajtohen nga Byroja me autonomi të plotë në përputhje me parashikimet ligjore dhe rregulluese që zbatohen në vendin e aksidentit në lidhje me përgjegjësinë dhe kompensimin e palëve të dëmtuara.

## KREU X

### **DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR TRAJTIMIN E DËMIT QË RRJEDH NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË PËRGJEGJËSISË SË PRONARËVE TË AVIONIT PËR DËMIN SHKAKTUAR PALËVE TË TRETA**

### Neni 40

#### **E drejta për dëmshpërblim**

Shoqëria e sigurimit dëmshpërblen:

- a) çdo dëm shkaktuar palëve të treta, me pasojë vdekje, dëme trupore, përkeqësim të gjendjes shëndetësore dhe dëmtim apo shkatërrim të pasurisë gjatë fluturimit të avionit;
- b) dëme shkaktuar pasagjerëve me pasojë vdekje, dëme trupore, përkeqësim të gjendjes shëndetësore gjatë përdorimit të avionëve;
- c) dëmtime ose humbje të sendeve personale të pasagjerëve që janë të vendosura në kabinën e avionit;
- d) dëmtime ose humbje të mallrave në transport (cargo) dhe të bagazheve që kanë kaluar procesin e regjistrimit.

### Neni 41

#### **Kërkesa për dëmshpërblim**

1. Në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë siguruesin përgjegjës të pronarit të avionit.

2. Pala e dëmtuar, sipas Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë, humbet të drejtat e tij për dëmshpërblim nëse ai nuk paraqet kërkesë brenda një periudhe prej 3 vjetësh, nga momenti kur ai vihet në dijeni për dëmet dhe për personin përgjegjës të aksidentit.

3. Kërkesa për dëmshpërblim paraqitet me shkrim ose në mënyrë elektronike.

4. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të pranojë dhe të regjistrojë kërkesën për dëmshpërblim.

5. Nëse pala e dëmtuar paraqet fakte false apo mashtruese lidhur me ngjarjen e ndodhur, shoqëria ka të drejtë të refuzojë kërkesën për dëmshpërblim.



#### Neni 42

### Afatet e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim

Siguruesi është i detyruar të trajtojë kërkesën për dëmshpërblim, të bëjë verifikimet e nevojshme dhe të njoftojë për masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim.

#### Neni 43

### Dokumentacioni i dosjes së dëmit

1. Dosja e dëmit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarëve të avionëve për dëmin shkaktuar palëve të treta përmban:

a) Njoftimin/kërkesën e të siguruarit/palës së dëmtuar ose përfituesit të tij, në rastin kur i dëmtuari vdes, për dëmshpërblim sikurse përcaktohet në nenin 41 të kësaj rregulloreje;

b) Raportin e plotë të autoritetit kompetent të trafikut ajror për ngjarjen e ndodhur, duke dhënë të gjitha hollësitë e nevojshme për ndodhjen e një ngjarjeje të tillë, si dhe çdo dokumentacion tjetër që vërteton ngjarjen e ndodhur;

c) Raporti për ngjarjen e ndodhur duhet të përmbajë njoftim për çdo ndjekje penale që ka lidhje me ngjarjen;

d) Konfirmimin e mbulimit në sigurim nga shoqëria e sigurimit;

e) Dokumentacionin që vërteton dëmtimin ose humbjen e sendeve personale të pasagjerëve që janë të vendosur në kabinën e avionit, si dhe të mallrave në transport (cargo) dhe bagazheve;

f) Dokumentacioni që vërteton dëmtimin ose shkatërrimin të pasurisë gjatë fluturimit të avionit;

g) Biletën e udhëtimit/karta ose ndonjë dokument tjetër në origjinal që provon se pala e dëmtuar ka qenë pasagjer;

h) Certifikatën mjekësore e plotësuar dhe e lëshuar nga mjeku që ka bërë vizitën e parë mjekësore e personit të dëmtuar;

i) Raportin mjekësor mbi shkallën e paaftësisë. Raporti i paaftësisë së përhershme për punë, i cili duhet të shprehë në përqindje masën e paaftësisë, duke u bazuar në tabelën “Shkalla e humbjes së paaftësisë së përhershme në punë”;

j) Radiografi/skaner/rezonancë manjetike/epikrizë/anamezë, fletështrimi dhe fletëdalja nga spitali dhe çdo dokument tjetër që ndihmon në vlerësimin e dëmit, i lëshuar nga organet kompetente;

k) Dokumentin i identifikimi të personit të dëmtuar;

l) Certifikatën e vdekjes (në rast të vdekjes së personit);

m) Skedën e vdekjes;

n) Vendimin e Gjykatës për përcaktimin e trashëgimtarëve të të ndjerit;

o) Deklaratën e pranimit të dëmshpërblimit, e cila do të shërbejë si provë për pranimin e vlerës së dëmshpërblimit nga pala e dëmtuar.

2. Përveçsa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni, dosja e dëmit mund të përmbajë edhe dokumente të tjera plotësuese që lidhen me trajtimin e dosjes së dëmit.

#### Neni 44

### Përlllogaritja e dëmit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarëve të avionëve për dëmin shkaktuar palëve të treta

1. Përlllogaritja e dëmit me pasojë vdekje, dëmtime trupore dhe përkeqësim të gjendjes shëndetësore, do të bëhet sipas parashikimeve të kreut III të kësaj rregulloreje.

2. Përlllogaritja e dëmit me pasojë dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë do të bëhet me vlerën e zëvendësimit të pasurisë së dëmtuar ose të shkatërruar, por jo më shumë se limiti i përcaktuar në nenin 49 të ligjit nr.10 076, datë 12.2.2009.

3. Përlllogaritja e dëmtimeve ose humbjeve të sendeve personale të pasagjerëve të vendosura në kabinën e avionit do të jetë në masën 1000 SDR.

4. Përlllogaritja e dëmtimeve ose humbjeve të mallrave në transport dhe të bagazheve që kanë kaluar procesin e regjistrimit (check-in) do të jetë 17 SDR për kg, sipas dokumentacionit shoqëruar të mallit.

5. Masa e dëmshpërblimit e përlllogaritur sipas këtij neni, nuk mund të jetë më e madhe se shumata e sigurimit e përcaktuar në nenin 49 të ligjit nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

## KREU XI

### DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR TRAJTIMIN E DËMIT QË RRJEDH NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË PËRGJEGJËSISË SË PRONARËVE TË MJETEVE TË VOGLA LUNDRUESE PËR DËMIN E SHKAKTUAR PALËVE TË TRETA

#### Neni 45

#### **E drejta për dëmshpërblim**

Shoqëria e sigurimit dëmshpërblen çdo dëm pasuror dhe jopasuror që u shkaktohet palëve të treta dhe që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive së pronarëve të mjeteve të vogla lundruese për dëmin e shkaktuar palëve të treta.

#### Neni 46

#### **Kërkesa për dëmshpërblim**

1. Në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë siguruesin përgjegjës të pronarit të avionit.

2. Kërkesa për dëmshpërblim paraqitet me shkrim ose në mënyrë elektronike.

3. Shoqëria e sigurimit është e detyruar të pranojë dhe të regjistrojë kërkesën për dëmshpërblim.

4. Nëse pala e dëmtuar paraqet fakte false apo mashtruese lidhur me ngjarjen e ndodhur, shoqëria ka të drejtë të refuzojë kërkesën për dëmshpërblim.

#### Neni 47

#### **Afatet e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim**

Siguruesi është i detyruar të trajtojë kërkesën për dëmshpërblim, të bëjë verifikimet e nevojshme dhe të njoftojë për masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim për dëmet pasurore dhe brenda 90 ditëve nga data e plotësimit të dokumentacionit për dëmet jopasurore.

#### Neni 48

#### **Dokumentacioni i dosjes së dëmit**

1. Dosja e dëmit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësive së pronarëve të mjeteve të vogla lundruese për dëmin shkaktuar palëve të treta përmban:

a) Njoftimin/kërkesën e të siguruarit/palës së dëmtuar ose përfituesit të tij (në rastin kur i dëmtuari vdes), për dëmshpërblim sikurse përcaktohet në nenin 46 të kësaj rregulloreje;

b) Dokumentacionin që vërteton regjistrimin e mjetit lundrues në regjistrin e mjeteve lundruese;

c) Raportin e plotë të autoritetit portual/organit kompetent përkatës për ngjarjen e ndodhur, duke dhënë të gjitha hollësitë e nevojshme për ndodhjen saj, si dhe çdo dokumentacion tjetër që vërteton ngjarjen e ndodhur;





d) Raporti për ngjarjen e ndodhur duhet të përmbajë njoftim për çdo ndjekje penale që ka lidhje me ngjarjen.

e) Konfirmimin e mbulimit në sigurim nga shoqëria e sigurimit;

f) Dokumentacionin që vërteton dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë;

g) Certifikatën mjekësore të plotësuar dhe të lëshuar nga mjeku që ka bërë vizitën e parë mjekësore të personit të dëmtuar;

h) Raportin mjekësor mbi shkallën e paaftësisë. Raporti i paaftësisë së përhershme për punë duhet të shprehë në përqindje masën e paaftësisë, duke u bazuar në tabelën “Shkalla e humbjes së paaftësisë së përhershme në punë”;

i) Radiografi/skaner/rezonancë manjetike/epikrizë/anamezë, fletështrimi dhe fletëdalja nga spitali, si dhe çdo dokument tjetër që ndihmon në vlerësimin e dëmit, i lëshuar nga organet kompetente;

j) Dokumentin e identifikimit të personit të dëmtuar;

k) Certifikatën e vdekjes ( në rast të vdekjes së personit);

l) Skedën e vdekjes;

m) Vendimi i gjykatës për përcaktimin e trashëgimtarëve të të ndjerit;

n) Deklaratën e pranimit të dëmshpërblimit, e cila do të shërbejë si provë për pranimin e vlerës së dëmshpërblimit nga pala e dëmtuar.

2. Përveçsa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni, dosja e dëmit mund të përmbajë edhe dokumente të tjera plotësuese që lidhen me trajtimin e tij.

#### Neni 49

### **Përlllogaritja e dëmit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarëve të mjeteve të vogla lundruese për dëmin shkaktuar palëve të treta**

1. Përlllogaritja e dëmit me pasojë vdekje, dëmtime trupore dhe përkeqësim të gjendjes shëndetësore, do të bëhet sipas parashikimeve të kreut III të kësaj rregulloreje.

2. Përlllogaritja e dëmit jopasuror do të bëhet sipas parashikimeve të kreut VI të kësaj rregulloreje.

3. Përlllogaritja e dëmit me pasojë dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë do të bëhet me vlerën e zëvendësimit të pasurisë së dëmtuar ose të shkatërruar.

4. Masa e dëmshpërblimit e përlllogaritur sipas këtij neni, nuk duhet të jetë më e madhe se shuma e sigurimit e përcaktuar në nenin 51 të ligjit nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

#### KREU XII

#### Neni 50

### **Kontabilizimi i dëmeve**

1. Pagesa e dëmshpërblimit kryhet nga shoqëria e sigurimit, përgjegjëse, BSHS ose nga siguruasi i drejtpërdrejtë nëse është lidhur një marrëveshje midis tyre.

2. Shpenzimet për dëme klasifikohen të ndara në: “shpenzime për dëme të paguara” dhe “shpenzime për trajtim dëmsh”.

3. Në zërin “Shpenzime për dëme të paguara” regjistrohet vlera e dëmshpërblimit që përfiton personi i dëmtuar/familjarët e tij/palë të treta në rastin e riparimeve të mjeteve të dëmtuara në servis ose klinikave mjekësore, i llogaritur sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.

4. Shpenzimet për dëme të paguara klasifikohen të detajuara sipas llojit të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, si dhe sipas çdo portofoli sigurimi.

5. Në zërin “Shpenzime për trajtim dëmsh” regjistrohen shpenzimet e tjera që lidhen drejtpërdrejt me trajtimin e dëmeve. Këtu përfshihen:

- a) shpenzime për vlerësuesit e dëmeve;
  - b) konsulenca për trajtim dëmsh;
  - c) ekspertiza;
  - d) investigime;
  - e) shpenzime gjyqësore dhe noteriale;
  - f) shpenzime për parandalim dëmsh;
  - g) shpenzime për rimorkim, parkim;
  - h) kosto të marrjes me qira në rastin kur shoqëria e sigurimit vë në dispozicion të palës së dëmtuar mjet me qira deri në riparimin e mjetit të tij;
  - i) të tjera shpenzime që lidhen drejtpërdrejt me trajtim dëmsh.
6. Në rastin e pagesës së dëmshpërblimit nga siguroesi i drejtpërdrejtë, ky i fundit i pasqyron shpenzimet e mësipërme sipas standardeve të kontabilitetit, ndërsa shoqëria e sigurimit përgjegjëse i pasqyron ato menjëherë me plotësimin e dosjes së dëmit.
7. Regjistrimet e mësipërme duhet të pasqyrohen të rregullta dhe të sinqerta, në përputhje me standardet e kontabilitetit.

### KREU XIII

#### Neni 51

#### **Dispozita kalimtare dhe të fundit**

1. Dosjet e dëmeve, ngjarja e sigurimit e të cilave ka ndodhur pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 076, datë 12.2.2009 dhe janë në proces trajtimi nga shoqëria e sigurimit dhe Byroja Shqiptare e Sigurimit, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, trajtohen sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.
2. Tabela nr.1 “Koefficientet e llogaritjes së shumës së kapitalizuar” dhe tabela nr.2 “Shkalla e humbjes së aftësisë për punë”, janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e botimit të saj në faqen elektronike zyrtare të Autoritetit.

**KRYETARE**  
**Elisabeta Gjoni**

TABELA NR.1

#### KOEFIICIENTET E LLOGARITJES SË SHUMËS SË KAPITALIZUAR

MOSHA	KOEFIICIENTI	MOSHA	KOEFIICIENTI	MOSHA	KOEFIICIENTI	MOSHA	KOEFIICIENTI
12	20.048	34.6	17.353	57	11.532	79.6	4.058
12.6	19.990	35	17.268	57.6	11.356	80	3.939
13	19.931	35.6	17.181	58	11.180		
13.6	19.874	36	17.093	58.6	11.002		
14	19.818	36.6	17.002	59	10.802		
14.6	19.762	37	16.910	59.6	10.644		
15	19.707	37.6	16.815	60	10.464		
15.6	19.652	38	16.720	60.6	10.283		
16	19.598	38.6	16.621	61	10.102		
16.6	19.544	39	16.523	61.6	9.919		
17	19.490	39.6	16.420	62	9.737		
17.6	19.437	40	16.318	62.6	9.554		
18	19.383	40.6	16.211	63	9.371		
18.6	19.331	41	16.104	63.6	9.188		
19	19.279	41.6	15.994	64	9.005		
19.6	19.228	42	15.883	64.6	8.821		
20	19.177	42.6	15.768	65	8.638		
20.6	19.127	43	15.652	65.6	8.454		
21	19.077	43.6	15.533	66	8.270		
21.6	19.027	44	15.413	66.6	8.086		
22	18.973	44.6	15.289	67	7.903		



22.6	18.928	45	15.165	67.6	7.722		
23	18.878	45.6	15.037	68	7.541		
23.6	18.827	46	14.908	68.6	7.363		
24	18.777	46.6	14.775	69	7.185		
24.6	18.724	47	14.642	69.6	7.011		
25	18.67	47.8	14.504	70	6.837		
25.6	18.614	48	14.367	70.6	6.667		
26	18.557	48.6	14.225	71	6.496		
26.6	18.498	49	14.083	71.6	6.631		
27	18.439	49.6	13.937	72	6.165		
27.6	18.337	50	13.792	72.6	6.005		
28	18.315	50.6	13.642	73	5.846		
28.6	18.250	51	13.493	73.6	5.691		
29	18.185	51.6	13.339	74	5.537		
29.6	18.177	52	13.185	74.6	5.389		
30	18.019	52.6	13.028	75	5.241		
30.6	17.977	53	12.871	75.6	5.099		
31	17.906	53.6	12.710	76	4.957		
31.6	17.831	54	12.548	76.6	4.821		
32	17.757	54.6	12.383	77	4.685		
32.6	17.679	55	12.217	77.6	4.555		
33	17.601	55.6	12.048	78	4.425		
33.6	17.569	56	11.878	78.6	4.301		
34	17.438	56.6	11.705	79	4.177		

TABELA NR.2  
SHKALLA E HUMBJES SË AFTËSISË SË PËRHERSHME PËR PUNË  
(në përqindje)

1. Koka

1.1 Manifestime të dhimbshme të rënda të vazhdueshme pas dëmtimeve traumatike të kokës (të kafkës dhe të trurit) - goditje psikike, dobësi mendjeje, kriza epileptike të shpeshta, paralizë, afazi, apraksi, agnozi, çrregullime të skemës së trurit, tronditje vestibulare të rëndësishme 100%

1.2 Manifestime të dhimbshme të vazhdueshme, por më pak të rënda pas dëmtimeve traumatike të kokës (të kafkës dhe të trurit) – prekje organike të nervave - kranio - cerebral, çrregullime të madhësisë së lëvizjeve dhe të fuqisë në ekstremitetet, çrregullimi i koordinimit të lëvizjeve, hiperkinezi, çrregullim i rëndësishëm i tonuzit, kriza epileptike jo të shpeshta, dobësim i konsiderueshëm i kujtesës, i intelektit mungesë kurajoje 70-90%

1.3 Manifestime reziduale pas tronditjes së trurit: neurozë postkoocionale e shoqëruar me manifestime reziduale të vazhdueshme edhe pas mjekimit, çrregullime të vazhdueshme të funksioneve të sistemit nervor vegetativ, disfunkcion hormonal, çrregullim i metabolizmit, sindromë paraksizmale jo të shpeshta, kriza vestibulare, kriza epileptiforme, çrregullim i organeve të shqisave, të të nuhaturit, të shijimit 30-70%

1.4 Manifestime reziduale pas kontuzionit të kokës, dhimbje koke të fortë, marrje mendsh, irritacion, lodhje e shpejtë çrregullim i gjumit, djersitje manifestim kardiovaskular, simptoma vegetative, manifestime reziduale të parëndësishme të prekjës së nervave taranio-cerebral (shenja organike të lehta) etj. 10-30%

2. Sytë

2.1 Humbje e plotë e shikimit me të dy sytë 100%

2.2 Humbje e plotë e shikimit me njërin sy, duke ruajtur mprehtësinë normale të shikimit të syrit tjetër (1:0) 35%

2.3 Kur pakësohet mprehtësia e shikimit, përqindja e humbjes së aftësisë në punë caktohet sipas tabelës së poshtëshënuar:

Vizur	Në përqindje										
	1.0	0,9	0,8	0,7	0,6	0,5	0,4	0,3	0,2	0,1	0,0
1	0	5	5	5	5	10	10	15	20	24	35
0,9	5	5	5	5	10	10	15	15	20	30	35
0,8	5	5	5	10	10	15	15	20	25	30	40
0,7	5	5	10	10	15	15	20	20	25	35	40
0,6	5	10	10	15	15	20	20	25	30	35	40 (45)
0,5	10	10	15	15	20	20	25	30	35	40	50
0,4	10	15	15	20	20	25	30	35	40	45	55
0,3	15	15	20	20	25	30	35	40	45	50	60
0,2	20	20	25	25	30	35	40	45	55	60	70
0,1	25	30	30	35	35	40	45	50	60	75	85
0,0	35	35	40	40	45	50	55	60	70	80	100

- 2.4 Afaki e njëanshme 100%
- 2.5 Dipllopi sipas gradës dhe hemianopsi e njëanshme sipas gradës 20-60%
- 2.6 Paralizë e akomodimit të një syri dhe paraliza të tjera sipas gradës 10-25%
- 2.7 Ploze (rënia e qepallës) sipas gradës 10-25%
- 2.8 Ngushtim koncentruar i fushës vizive në njërin sy 10%
- 2.9 Ngushtim i kanaleve nazalo-lakrimale me rrjedhje lotësh 15%
- 2.10 Pamjaftësi e qepallave për të mbuluar globin ocular sipas gradës 15-25%
- 2.11 Ngjitja e qepallës me syrin, duke penguar lëvizjen e syrit 15%
- 2.12 Ekzoftalm ose bilateral shoqëruar me ulje të mprehtësisë së pamjes 50-100%
- 3. Veshët
- 3.1 Pakësim i fortë i të dëgjuarit (e folur me zë të ulët: 0) me njërin vesh ose me të dy veshët 15-30%
- 3.2 Pakësim mesatar i të dëgjuarit (e folur me zë të ulët nga një distancë më tepër se një metër) me një vesh ose me të dy veshët 10-15%
- 3.3 Shurdhim i plotë i njërit vesh ose i të dyve 15-50%
- 3.4 Inflamacion kronik me qelb i veshit të mesit, i tipit mezoimpanit dhe të tipit eptimpanit ose komplikuar me kolesteatoma 15-25%
- 3.5 Çrregullime objektive të funksionit vestibular sipas gradës dhe komplikacione endokraniale 10-60%
- 3.6 Humbja e llapës së veshit, si dhe defiguracioni i saj 15%
- 4. Fytyra
- 4.1 Cikatrizime superficiale të shumta që shëmtojnë fytyrën, por që nuk shkaktojnë çrregullime funksionale 15%
- 4.2 Lezione të fytyrës të shoqëruara me çrregullime funksionale: ngushtimi gojës dhe i vestibulit të gojës, pakësim i lëvizjes së nofullës së poshtme, formim i një fistule salivare sipas gradës 25-50%
- 4.3 Dëmtime të kockave të hundës, nofullave të sipërme e të poshtme dhe të kockave të tjera të fytyrës që shkaktojnë çrregullime funksionale sipas gradës 25-40%
- 4.4 Humbje dhëmbësh gjatë fatkeqësisë sipas numrit të dhëmbëve të humbur 5-15%
- 5. Hunda
- 5.1 Humbja e hundës 30-40%
- 5.2 Vështirësim i respiracionit nga hunda (thyerje-ngushtim i zgavrës nazale) 15%



5.3	Sëmundje me qelb e anekseve të kavitetit nazal, si dhe të shoqëruara me dhimbje koke, si rrjedhje të lëngut cereba-spinal	25-40%
5.4	Humbje e shqisës së të nuhaturit	10%
6.	Qafa dhe laringu	
6.1	Kufizim i lëvizjes së qafës nga shkaku i dëmtimeve traumatike të indeve të buta sipas gradës	10-30%
6.2	Afoni (humbja e zërit), paralizë e njërit nga nervat sekuronk	25%
6.3	Vështirësim i respiracionit nga shkaku i ngushtimit permanent të laringut sipas gradës, në paralyzebilateralee sekusensit-stenozot-gjendje e trakeotramizuar	70%
6.4	Dëmtim i laringut ose pasoja të dëmtimeve të tjera të qafës që japin funksionale dhe për jetën	75%
7.	Kraharori	
7.1	Pakësimi i lëvizjes së kafazit të kraharorit nga shkaku i dëmtimeve të ndryshme të tij-thyerje e brinjëve, cikatrizime sipas gradës	10-30%
7.2	Deformacion i kafazit të kraharorit tepër i prononcuar	40%
7.3	Manifestime rezirlulle permanente pas një prevriti traumatic, pakësim i lëvizjeve respiratore të mushkërive-pakësimi i sipërfaqes respiratore nga shkaku i aderencave me pjesët e afërta etj., sipas gradës	15-70%
7.4	Sëmundje kronike të indit pulmonar (sipas gravitetit të prekjes)	25-100%
7.5	Sëmundje organike të zemrës të cipave të saj (inflamacion kronik i miokardit anevrizma) dhe të vazevet (sipas rëndësisë së prekjes)	25-100%
8.	Barku	
8.1	Sëmundje kronike të organeve abdominale dhe të ezofagut të shoqëruara me çrregullime në tretjen e ushqimeve dhe pakësimin në peshë (ngushtim i ezofagut, i stomakut, fistula të tyre, influencon kronik i peritoneumit, sëmundje të mëlçisë së zezë, zmadhim dhe heqje e shpretkës, sëmundjet e organeve gjentiale të gruas etj., sipas rëndësisë se prekjes	25-100 %
8.2	Dëmtime të mureve abdominale të shoqëruara me çrregullime të pressioabdominales (këputjes, parez muskujsh ose formim cikatrizash të mëdha)	25%
8.3	Shkarja e zorrëve, e mitrës (që shfaqen si konsekuencë e rastit të fatkeqësisë)	25%
8.4	Hernia e paoperuar ose e operuar me përfundim (në inguinjo të kënaqshëm, në inguinjo në regjionin gluteal, në numrin abdominal)	10-50%
9.	Organet urinare dhe seksuale	
9.1	Sëmundje kronike të veshkave të pelvis reuale dhe të uretereve sipas gradës	30-70%
9.2	Heqje e një veshke	50%
9.3	Veshkë endëse (errante)	35%
9.4	Çrregullim i bërjes së urinës shkaktuar nga dëmtime në zonën e organeve urogenitale sipas gradës	15-50%
9.5	Fistule të kanalit urinar dhe të fshikëzës së urinës	50%
9.6	Idrocele në testiculum ose në duktur seminale	40%
9.7	Humbje e organeve seksuale (penis)	40%
9.8	Humbje e të dy testikujve	60%
9.9	Humbje e një testikuli	30%

10. Shtylla kurrizore		
10.1 Dëmtime të shtyllës kurrizore të shoqëruara me simptomë objektive të vazhdueshme të çrregullimeve të funksioneve të palcës kurrizore ose të sistemit nervor periferik (paralizë e ekstremiteteve, çrregullime të organeve të bacinit etj.)		100%
10.2 Sëmundje të kolonës vertebrale (në çdo seksion të saj), të cipës kurrizore të rrënjëve, të pleksjeve të qafës dhe të supit të shoqëruara me çrregullime të funksioneve të ekstremiteteve: pakësim i volumit të lëvizjeve, pakësim i fuqisë, çrregullim i sensibilitetit, ndryshim i reflekseve sipas gradës		20-60%
10.3 Këputje dhe tendosje të muskujve të kurrizit sipas gradës		10-50%
10.4 Kufizim i lëvizjes së kolonës vertebrale, sipas gradës		10-50%
10.5 Kufizim i lëvizshmërisë së kolonës vertebrale që lyp një mbajtje të përhershme të korsetit		70%
11. Basini		
11.1 Prishje e unitetit të hallkës së basinit (fiksion jo i plotë i artikulacionit sakro-ileak)		25%
11.2 Thyerje e kockave të basinit të shoqëruara me çrregullime të funksioneve të ekstremiteteve, sipas gradës		20-60%
12. Ekstremitete të sipërme		
	Dora	
1. Gishti i madh	Djathtë	Majtë
12.1.1 Humbje e falangës së thoit	15%	10%
12.1.2 Humbje e falangës së thoit me gjysmën e falangës	20%	15%
12.1.3 Humbje e të dyja falangave vetëm ose së bashku me metakarp	30%	20%
12.1.4 Imobilitet i artikulacionit metaka profalangjial dhe metakar po karpal	15%	10%
12.1.5 Imobilitet i artikulacioneve midis falangeve	10%	5%
12.1.6 Imobilitet i të dyja artikulacioneve falange të çfarëdoshme	20%	15%
12.1.7 Imobilitet i të tria artikulacioneve	30%	25%
12.1.8 Mobilitet i vështirë penanent i gishtit të madh	10%	5%
12.1.9 Kontraktura fleksive dhe ekstensive e gishtit të madh	25%	15%
12.1.10 Shkurtim dhe defonim i gishtit të madh	20%	15%
12.1.11 Shëmtim (defiguracion) i thoit ose defekt në falangën e tij	10%	5%
2. Gishti tregues		
12.2.1 Humbje e falangës së thoit	10%	5%
12.2.2 Humbje e falangës së thoit dhe e falangës së mesme	15%	10%
12.2.3 Humbje e të tria falangave dhe e të tria falangave me kockën e dytë metokarpale	25%	15%
12.2.4 Imobilitet i artikulacionit të parë	15%	10%
12.2.5 Imobilitet i artikulacionit të parë dhe artikulacionit të mesëm	20%	15%
12.2.6 Imobilitet i artikulacionit të parë dhe artikulacionit të tretë	15%	10%
12.2.7 Imobilitet i artikulacionit të mesëm	10%	5%
12.2.8 Imobilitet i artikulacionit të tretë	5%	5%
12.2.9 Imobilitet i artikulacionit të mesëm dhe i artikulacionit të tretë	15%	10%
		10149



12.2.10	Imobilitet i të tria artikulacioneve	25%	20%
12.2.11	Imobilitet i vështirë pënnanent i gishtit tregues	10%	5%
12.2.12	Kontrature fleksive ose ekstensive	25%	10%
12.2.13	Shkurtim dhe defonnim i gishtit tregues	15%	10%
12.2.14	Shëmtim i thoit ose difekte në pjesët e buta të falangës së tij	5%	5%
3.	Gishti i mesëm, i unazës dhe i vogël		
12.3.1	Humbje e falangës së thoit	5%	5%
12.3.2	Humbje e falangës së thoit dhe e falangës së mesme	10%	5%
12.3.3	Humbje e njërit prej këtyre gishtërinjve	10%	5%
12.3.4	Idem bashkë me kockën metakaipale	15%	10%
12.3.5	Imobilitet i të tria artikulacioneve ose i të parit dhe të mesit	15%	10%
12.3.6	Imobilitet i artikulacionit të parë	10%	5%
12.3.7	Imobilitet i artikulacionit të mesëm	10%	5%
12.3.8	Imobilitet i artikulacionit të artikulacionit të tretë	10%	5%
12.3.9	Imobilitet i artikulacionit të mesëm dhe të tretë	10%	5%
12.3.10	Imobilitet vetëm i artikulacionit të tretë	5%	5%
12.3.11	Imobilitet i vështirë pënnanent i njërit prej këtyre gishtërinjve	5%	5%
12.3.12	Kontraktor fleksiv ose ekstensiv	10%	5%
12.3.13	Shkurtim dhe defonnim	10%	5%
4.	Dëmtim të të gjithë ose disa gishtërinjve të një dore		
12.4.1	Humbje e të gjithë gishtërinjve	75%	60%
12.4.2	Imobilitet i të gjithë gishtërinjve	65%	55%
12.4.3	Imobilitet i vështirë i të gjithë gishtërinjve	40%	20%
12.4.4	Kontrature e të gjithë gishtërinjve	55%	40%
12.4.5	Humbje e dy gishtërinjve të një dore		
a)	E gishtit të madh dhe tregues	50%	40%
b)	E gishtit të madh së bashku me gishtin e mesëm ose me gishtin e unazës ose me gishtin e vogël	40%	30%
c)	E gishtit tregues së bashku ose me gishtin e mesëm ose me gishtin e unazës ose me gishtin e vogël	35%	25%
d)	E gishtit të mesëm së bashku ose me gishtin e unazës, ose me gishtin e vogël	30%	20%
f)	E gishtit të unazës dhe e gishtit të vogël	20%	15%
12.4.6	Humbje e tre gishtërinjve të një dore		
a)	E gishtit të madh tregues së bashku me gishtin e unazës ose me gishtin e mesëm ose me gishtin e vogël	60%	50%
b)	E gishtit të madh dhe të mesëm së bashku ose me gishtin e unazës ose me gishtin e vogël	45%	35%
c)	E gishtit të madh të unazës dhe të gishtit të vogël	45%	35%
d)	E gishtit tregues dhe të mesëm së bashku me gishtin e unazës ose me gishtin e vogël	45%	30%
f)	E gishtit tregues e gishtit të unazës dhe e gishtit të vogël.	45%	30%
g)	E gishtit të mesëm e gishtit të unazës dhe e gishtit të vogël	30%	20%
12.4.7	Humbja e katër gishtërinjve të një dore		
a)	E gishtit të madh e gishtit tregues dhe të mesëm së bashku ose me gishtin e unazës ose me gishtin e vogël	65%	50%

b) E gishtit të madh e gishtit tregues të unazës dhe gishtit të vogël	60%	50%
c) E gishtit të madh e gishtit të mesëm të unazës dhe të vogël	60%	45%
d) E gishtit tregues të mesëm të unazës dhe të vogël	65%	50%
5. Dëmtimi i të gjithë ose i disa gishtërinjve të të dyja duarve		
12.5.1 Humbje e të gjithë gishtërinjve, si edhe nëngishtërinjve të të dyja duarve		100%
12.5.2 Humbje e gishtërinjve të mëdhenj dhe tregues në të dyja duart		85%
12.5.3 Humbje e gishtërinjve tregues në te dyja duart		40%
12.5.4 Humbja e gishtit të madh dhe e gishtit tregues të dorës së djathtë dhe e gishtit tregues të dorës së majtë		60%
12.5.5 Humbje e gishtit të madh dhe tregues të dorës së majtë dhe e gishtit tregues të dorës së djathtë		55%
12.5.6 Humbje e gishtit të madh tregues dhe të mesëm ose e gishtit të unazës ose e gishtit të vogël të dorës se djathtë dhe e gishtit tregues të dorës së majtë		70%
12.5.7 Humbje e gishtit të madh tregues dhe të mesëm ose e gishtit të unazës ose e gishtit të vogël të dorës së majtë dhe e gishtit tregues të dorës së djathtë		60%
12.5.8 Humbje e të gjithë gishtërinjve të dorës së djathtë përveç gishtit tregues dhe humbje e gishtit të madh të dorës së majtë		60%
12.5.9 Humbje e të gjithë gishtërinjve të dorës së majtë përveç gishtit tregues dhe humbje e gishtit të madh të dorës së djathtë		60%
		Dorë
6. Kyçi i dorës	Majtë	Djathtë
12.6.1 Humbje e tërë kyçit (e karpit)	75%	60%
12.6.2 Imobilitet i artikulationitradio-karp	40%	30%
12.6.3 Imobilitet i vështirë në artikulationinradiokarpal	15%	10%
12.6.4 Pseudoartrozë e artikulationitradiokarpal	50%	40%
12.6.5 Thyerje të kockave karpale që tronditin zotësinë e kapjes së sendeve me dorë të shoqëruara me një sindromë dhimbjeje permanente	20%	10%
7. Llëra		
12.7.1 Humbja e heresderit në artikulationin e bërrylit	75%	60%
12.7.2 Imobilitet në artikuacionin e bërrylit në pozicionin fleksion ekstension në kënd të gjerë	50%	40%
12.7.3 Imobilitet në artikulationin e bërrylit në një pozicion në fleksion në kënd të drejtë	30%	20%
12.7.4 Lëvizje e vështirë në artikulationin e bërrylit	20%	15%
12.7.5 Pseduoartrozë në artikulationin e bërrylit	60%	50%
12.7.6 Lëvizje të kufizuara të kyçit (në abduksion, pronacion dhe supinacion)	25%	15%
12.7.7 Lëvizje e vështirë në artikulationin e bërrylit dhe radiokarpal	30%	20%
12.7.8 Thyerje të konsoliduara jo në rregull të të dyja kockave të llërës që vështirësojnë lëvizjen e kyçit ose të gishtërinjve të dorës	30%	20%
12.7.9 Imobilitet në artikulationin e bërrylit dhe radiokarpal	55%	40%





8.	Krahu		
12.8.1	Humbja e krahut deri në mes të artikulationit të supit dhe të bërrylit	75%	60%
12.8.2	Imobilitet në artikulationin e supit	60%	50%
12.8.3	Pseudoartrozë e kockës së krahut	65%	50%
12.8.4	Lëvizje e vështirë në artikulationin e supit	20%	10%
12.8.5	Pamundësi e ngritjes së krahut më lart pozicioni horizontal	40%	30%
12.8.6	Thyerje të konsoliduara jo në rregull të klavikulës ose të shpatullës nëse janë të shoqëruara me kufizim të lëvizjeve të krah	25%	15%
12.8.7	Thyerje të konsoliduara jo në rregull të kockës së krahut që vështirësojnë lëvizje të krahut	35%	25%
12.8.8	Atrofi të muskujve të krahut pas dëmtimeve të tyre	30%	15%
12.8.9	Luksacion i zakonshëm i supit	25%	15%
12.8.10	Humbje të të dy krahëve ose të kyçeve të duarve		100%
13.	Gjymtyrët e poshtme		
1.	Gishtërinjtë		
13.1.1	Humbje e gishtit të madh		15%
13.1.2	Humbje e falangës së thoit		5%
13.1.3	Çrregullim permanent i funksionit të gishtit të madh		5-15%
13.1.4	Humbje e një gishti tjetër të çfarëdoshëm		5%
13.1.5	Humbje e të gjithë gishtërinjve të një këmbë		25%
13.1.6	Humbje e kokave të kockave të metalaesit		50%
13.1.7	Thyerje e kockave të tarsit ose të metarsit të shoqëruara me çrregullime permanente të statikës ose me sindromë të dhimbshme të përhershme		15%
2.	Kyçi i këmbës		
13.2.1	Humbje e këmbës deri në artikulationin e tibio-tarsal ose më poshtë		60%
13.2.2	Humbje e metatarsit (amputacion deri në artikulationin e Lisfrang ose të Shopartit)		40%
13.2.3	Çrregullim permanent i funksionit të kyçit të këmbës pas thyerjes së talus ose cacaneus sipas gradës		10-40%
13.2.4	Lëvizje e kufizuar në artikulationintalo kural sipas gradës		10-20%
13.2.5	Imobilitet i artikulationit talo-kural të një këmbë me kyçin dhe kërcirin në pozicionin kënddrejtë		30%
13.2.6	Idem në pozicionin me kënd abtz		45%
13.2.7	Pseudoartrozë në artikulationin talo-kural		45%
13.2.8	Pedisplana si konsekuencë e dëmtimeve traumatike që nevojitet për mbajtjen permanente të një supinatori		20%
3.	Kërciri		
13.3.1	Humbja e kërcirit		60%
13.3.2	Imobilitet (ankilozë) i artikulationit të gjurit në gjendje të ngrirë drejt këmbës		40%
13.3.3	Idem në një fleksion të lehtë në kendaptuz		25%
13.3.4	Imobilitet i artikulationit të gjurit në gjendje fleksioni në një kënd të drejtë ose afër, ose në akstencion në anën e kundërt		50%
13.3.5	Pseudoartrozë e gjurit		60%
13.3.6	Dëmtime dhe sëmundje të artikulationit të gjurit që kanë shkaktuar kufizime permanente të funksionit të tij sipas gradës		20-40%

13.3.7	Procese kronike purulente të kërcirit me fisula me plagë të pashëruara sipas gradës	10-40%
13.3.8	Thyerje të konsoliduara jo në rregull të kockave të kërcirit me shkurtim dhe kufizim të lëvizjeve të ekstremitetit sipas gradës	10- 40%
13.3.9	Thyerje të pakonsoliduara e të dyja kockave të kërcirit (pseudoartrozë)	60%
13.3.10	Atrofi e muskujve të kërcirit pas dëmtimeve të ndryshme	20 - 40%
4.	Kofsha	
13.4.1	Humbja e kofshës deri në pjesën e tretë të sipërme të saj	70%
13.4.2	Idem më poshtë nga e treat e sipërme	60%
13.4.3	Imobilitet në artikulationin kosko-femural në këmbë në gjendje ekstension	50%
13.4.4	Idem në gjendje fleksioni të këmbës	60%
13.4.5	Lëvizje e kufizuar në artikulationin kosko-femural sipas gradës	30 - 40%
13.4.6	Thyerje e konsoliduar jo në rregull e kofshës me shkurtim dhe çrregullim të funksioneve të ekstremitetit sipas gradës	20 - 40%
13.4.7	Thyerje e pakonsoliduar e kofshës (pseudoartrozë)	70%
13.4.8	Atrofi e muskujve të kofshës sipas gradës	15- 30%
13.4.9	Tromboflebite traumatike ose edema permanente të estremiteve të poshtme sipas gradës	10- 40%
13.4.10	Humbje të të dyja këmbëve deri në kyçin e këmbës në kërci ose në kofshë	100%
13.4.11	Humbje e një këmbë ose e kyçit të këmbës me humbjen e një krahu ose të kyçit të dorës	100%

Shënim. Paralizat e plota të ekstremiteteve ose të pjesëve të tyre janë bars me humbjen e akstremiteteve. Humbja e plotë konsiderohet, gjithashtu, rrudhja e muskujve ose cikatrizimit, ulceracionet kronike, mbulim i pamjaftueshëm i monkoneve të kockës, pas një amputacioni i të ngjiturit ose të humburit të tendineve, nëse ato shkaktojnë pamundësi të plotë të përdoret ekstremiteti i dëmtuar ose një pjesë e tij.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 23.1.2012  
Doli nga shtypi më 25.1.2012

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë